



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në: “Psikologji
Shkollore dhe Edukimi”
Kolegji Universitar “Wisdom”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc.Dr. Artemisi SHEHU/ DONO

Prof.Asoc.Dr. Eglantina DERVISHI

Korrik / 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Wisdom”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Msc në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 192, datë 22.04.2016
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 228, date 23.11.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 73, datë 27.10.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	5 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	21 studentë
19	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar "Wisdom" ish Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Wisdom University" është krijuar nga shoqëria "Wisdom" sh.p.k. mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.672, datë 27.09.2006¹. Me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.254, datë 27.02.2008², është dhënë leja për zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë në Fakultetin e Drejtësisë dhe atë të Psikologjisë. Me Urdhër Nr.412 datë 25.08.2011 të MASR është miratuar riorganizimi i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Wisdom University" me dy fakultete, Fakulteti i Drejtësisë me tre njësi bazë, Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Private, Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Mardhënieve me Jashtë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike e Shoqërore me tre njësi bazë Departamenti i Ekonomisë, Departamenti i Psikologjisë, Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Mardhënieve me Jashtë. Me Urdhër Nr.355, datë 25.10.2015 të MASR është bërë Akreditimi Institucional i saj me kohëzgjatjen prej 3 (tre) vite akademike. Mbështetur në nenin 20, 33 dhe 129 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik me Vendimin Nr. 6, datë 03.02.2017³ vendosi riorganizimin e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Wisdom University" në Kolegj Universitar, me emërtimin Kolegji Universitar "Wisdom". Njësia bazë që ofron programin e studimit master i shkencave në "Psikologji shkollore dhe edukimi" është Departamenti i Psikologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike e Shoqërore. Programi i studimit është hapur me UMAS Nr. 192, datë 22.04.2016⁴ bazuar në (VKA Nr. 143, datë 31.03.2016⁵). Programi i studimit është akredituar për herë të parë me VBA Nr. 73, datë 27.10.2018⁶ (me kohëzgjatja 3 vite akademike, vlefshmëri deri më 30.09.2021). Programi i studimit master i shkencave në "Psikologji shkollore dhe Edukimi" i realizuar me 120 kredite (ECTS), në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohezgjatje normale 2 vite akademike, në gjuhën shqipe, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i shkencave në "Psikologji Shkollore dhe Edukimi"⁷. Ky program studimi është organizuar sipas ndarjes ku përfshihen lëndë të formimit bazë, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore / integruese, si dhe lëndët plotësuese dhe detyrime përmbyllëse ku si pjesë e të cilit është mbrojtja e temës së diplomës. Numri i studentëve të rregjistruar në programin e studimit master i shkencave në "Psikologji shkollore dhe Edukimi" për vitin akademik 2020 – 2021, është gjithsej 9 studentë.

¹ Vendim për dhënien e lejes për hapjen e SHLUP "Wisdom University".

² Vendim për hapjen e programeve të reja të studimit në SHLUP "Wisdom University".

³ Vendimi për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Kolegji Universitar "Wisdom".

⁴ Urdhër për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë të Msc. në Psikologji Shkollore dhe Edukimi, në Institucionin e SHLUJ Wisdom University.

⁵ Vendimi për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë të studimit, Msc. Psikologji Shkollore dhe Edukimi", të SHLUJ Wisdom University.

⁶ Vendimi për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Msc. Psikologji Shkollore dhe Edukimi", Kolegji Universitar Wisdom.

⁷ Aneksi 2.05. Vendim senati Nr. 11 Për Miratimin e Ndryshimeve të Planit mësimor.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Bazuar në Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 73, datë 27.10.2018, për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, Msc në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”, programi i studimit vlerësohet pozitivisht me kohëzgjatje 3 vjeçare, vlefshmëri deri më 30.09.2021⁸, me rekomandimet e mëposhtme:

- 1. Institucioni, të rishikojë brenda vitit akademik 2018-2019, kurrikulën e programit të studimit, me qëllim ribalancimin e komponentëve formues, përfshirjen dhe integrimin në kurrikulën ekzistuese të një numri më të madh lëndësh të fushës së edukimit dhe përputhjen e plotë të saj me emërtimin dhe objektivat formuese të programit.**

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni rezulton se janë ndërmarrë disa nisma nga institucioni për të përshtatur kurrikulën e programit të studimit të ciklit të dytë në përputhje me emërtimin dhe objektivat formuese të tij⁹. Njësia bazë ka realizuar një përshtatje të lëndëve të tilla si “Teoritë e komunikimit” (5 ECTS) duke u zëvendësuar me lëndën “Pedagogji” (6 ECTS), “Psikologji Motivacioni e Avancuar (4 ECTS) është zëvendësuar me lëndën “Teoritë dhe Modelet e Mësimdhënies” (8 ECTS). Këto dy lëndë e ndihmojnë profilizimin e këtij masteri në linjë edhe me fushën e edukimit, kjo inisiativë shihet me ndikim pozitiv në konsolidimin e këtij programi studimi në linjë me profilin dhe emërtimin e tij. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

- 2. Institucioni, të marrë masa serioze, për rekrutimin dhe plotësimin e stafit akademik me specialistë të fushës specifike të programit të studimit, për të garantuar cilësinë e ofertës akademike dhe përputhshmërinë e plotë të fushës e kualifikimit akademik të tyre me kurrikulën e përmirësuar e lëndët/modulet përkatëse.**

Referuar të dhënave që kemi nga KU “Wisdom” lidhur me angazhimin e stafit akademik në programin e studimit të ciklit të dytë Msc në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”, në përgjithësi stafi plotëson kriteret e kualifikimit profesional dhe akademik lidhur me fushën e studimit dhe profilin profesional të këtij masteri në dy linjat kryesore atë të psikologjisë dhe edukimit¹⁰. Kualifikimet në bazë të gradave dhe titujve akademik dhe përvojave profesionale të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi konsiderohet si element i rritjes së cilësisë në mësimdhënie. Rekrutimi i stafit akademik me profile të përafërta me fushën e këtij programi studimi pritet të garantojë cilësinë e ofertës akademike, te studentët e këtij programi studimi, në linjë edhe me lëndët mësimore që stafi akademik mbulon. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

⁸ Aneksi 2.04. Vendimi Nr.73 i Bordit të Akreditimit.

⁹ Aneksi 2.05. Vendim senati Nr. 11 Për Miratimin e Ndryshimeve të Planit mësimor.

¹⁰ Aneksi 2.26 Cv e stafit akademik të programit të studimit.

3. Institucioni, të shtojë marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione specifike të fushës së psikologjisë shkollore dhe edukimit, për të garantuar realizimin e praktikës mësimore/internship-it në përputhje me standardet e kërkuara dhe objektivat e programit të studimit.

Në funksion të praktikës profesionale janë nënshkruar një sërë marrëveshje¹¹ me institucione si “Drejtoria Arsimore Tiranë”, “Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve” Drejtoria Rajonale Verilindore”, Shkolla e mesme jopublike “Kristaq Rama”, Bashkia Tiranë, Qendra “Xhonatan” etj, pa afat. Këto marrëveshje bashkëpunimi¹² me institucione të specializuara në fushën e psikologjisë shkollore dhe të edukimit u japin mundësi studentëve të zhvillojnë praktikën profesionale pranë qendrave që kanë shërbim psikologjik dhe psikologë shkollorë në organikën e tyre. Në këtë mënyrë krijohen kushtet që studentët të përfitojë nga përvoja dhe profesionalizmi i profesionistëve të terrenit. Vlen të theksohet se qendrat e sipërpërmendura janë në përputhje me profilin e masterit shkencor në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”, duke krijuar mundësi reale në drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale të studentëve të këtij program studimi. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se **ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**

¹¹ Aneksi 4.07. Raporti i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

¹² Aneksi 4.09. Tabela e institucioneve bashkëpunuese.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit të ciklit të dytë master i shkencave në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”. Vlerësimi i programit të studimit është një proces vlerësimi nga ekspertë të jashtëm i përcaktuar me urdhër të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë “ Për përcaktimin e Ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Kolegji Universitar “Wisdom”. Grupi i vlerësimin të jashtëm i përbërë nga Prof. Asoc. Dr. Artemisi Shehu (drejtuese e grupit), Prof. Asoc. Dr. Eglantina Dervishi (anëtare), Msc. Majlinda Demireli (koordinatore teknike) nisi punën për realizimin e procesit të vlerësimin të jashtëm në kuadër të akreditimit të këtij program studimi.

Raporti përfundimtar do të shërbejë jo vetëm për akreditimin e programit bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve, por gjithashtu informon Kolegjin Universitar “Wisdom”, MASR, publikun e gjerë dhe studentët sesi programi i studimit përmbush standardet. Përmes këtij raporti njëjësia kryesore dhe bazë kanë mundësi të identifikojnë prioritetet në drejtim të rritjes dhe zhvillimit, duke e vënë theksin tek përmirësimi i cilësisë në drejtim të një procesi që zhvillon kompetencat profesionale dhe shkencore te studentët.

Standartet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë janë të grupuara në gjashtë fusha kryesore vlerësimi bazuar tek Ofrimi, Organizimi dhe Drejtimi i Programeve të Studimit Master i Shkencave/Arteve; Organizimi, Drejtimi dhe Administrimi i Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave/Arteve, Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat, Burimet njerëzore, Financiare, Infrastruktura, Logjistika për Realizimin e Programit të Studimit; Studentët dhe Mbështetja e tyre; Sigurimi i Cilësisë së Programeve të Studimit Master i Shkencave/Arteve. Vlerësimi i secilës fushe bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve me 4 nivele: a- nuk përmbushen; përmbushen pjesërisht; përmbushen kryesisht; përmbushen plotësisht. Raporti në tërësinë e tij identifikon pikat e forta të programit të studimit bazuar në karakteristikat e praktikës së mirë, pikat e dobëta të cilat prekin çdo fushë, mundësitë që ka në dispozicion programi në drejtim të avancimit drejt cilësisë dhe pengesat, të cilat mund të vështirësojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Mbi bazën e këtyre indikatorëve grupi i vlerësimin të jashtëm ka dhënë edhe rekomandimet profesionale që do të shërbejnë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të programit të studimit të ciklit të dytë master i shkencave në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”.

Kolegji Universitar "WISDOM", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 09.07.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 34/16 Prot, datë 09.07.2021. Kolegji Universitar "WISDOM", përcjell në ASCAL më datë 15 Korrik, me anë të shkresës me Nr. 107 Prot, datë 13.07.2021, "Mendimin për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm", ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave/ Arteve në "Psikologji Shkollore dhe Edukimi"

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve" që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Kolegji Universitar "Wisdom" (KU"Wisdom") zotëron të gjithë mekanizmat e nevojshëm në raport me funksionimin dhe organizimin e programit të studimit në përputhje me statutin e tij të brendshëm vendimit Nr. 7, datë 03.02.2017 të Senatit Akademik, ¹³ dhe vendimit Nr. 4, datë 31.01. 2017 të Bordit të Administrimit, si dhe rregulloren e KU "Wisdom" ¹⁴ e hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" ¹⁵ ; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" ¹⁶ . Kjo është evidentuar edhe në Rregulloren e njësisë kryesore ¹⁷ , si dhe atë të programit të studimit ¹⁸ që mbështetet

¹³ Aneksi 1.01. Statuti I Kolegjit Universitar "Wisdom".

¹⁴ Aneksi 1.02. Rregullore e Kolegjit Universitar "Wisdom".

¹⁵ Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri"https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 28-04-2021).

¹⁶ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>(Aksesuar më 28-04-2021).

¹⁷ Aneksi 1.05. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.

¹⁸ Aneksi 3.01. Rregullore e MSHPSHE.

	në misionin dhe qëllimet e tij dhe në linjë me nevojat e tregut të punës.
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Referuar statutit ¹⁹ dhe rregullores së njësisë kryesore ²⁰ , dhe rregullores së programit të studimit ²¹ të ciklit të dytë master i shkencave në "Psikologji Shkollore dhe Edukimi", ky program studimi respekton lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve, përmes një politike të brendshme që synon ndërthurjen midis kompetencave profesionale të studentit dhe pajisjen me diplomë profesionale referuar nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit është hartuar në frymën e kuadrit të ri ligjor dhe në përputhje me politikën e brendshme të institucionit dhe nevojave social-ekonomike të vendit. Programi i studimit të ciklit të dytë master i shkencave në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” është në përputhje me qëllimet dhe misionin e KU “Wisdom” dhe janë të integruara në linjë me fushën e studimit brenda njësisë bazë të tij. Gjithashtu duke iu referuar kushteve specifike përvoja të përkjet zhvillimit të profesioneve, ky profil ka prespektivë të mirë të zhvillohet me tej dhe të kontribuojë në mënyrë efikase në avancimin e kërkimit shkencor në drejtim të problemeve psiko-pedagogjike me të cilat ndeshet sistemi arsimor në vendin tonë
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ky program studimi i ciklit të dytë Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës për profesionist të kualifikuar. Përmes dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucioni dhe më specifikisht analizës së tregut të punës ²² përpara hapjes së këtij program studimi si dhe një studimi periodik i tij ²³ dhe bazuar në shqyrtimin e të dhënave nga institucione të ndryshme mbi nevojat për psikologë shkollore dhe edukimi është marrë vendimi i hapjes së tij. Studentet e këtij profili mund të kontribuojnë në një sërë kontekstesh profesionale përmes rolit të tyre si profesionist të disiplinës së psiko-pedagogjisë. Përmes dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucioni, si dhe më specifikisht përmes planit strategjik ²⁴ të këtij programi studimi, por edhe nga diskutimet me përgjegjësin e departamentit, mësohet se

¹⁹ Aneksi 1.01. Statuti I Kolegjit Universitar “Wisdom”.

²⁰ Aneksi 1.05. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.

²¹ Aneksi 1.05. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.

²² Aneksi 2.21. Studim për tregun e punës përpara hapjes së programit të studimit.

²³ Aneksi 2.22. Studimi periodik i tregut të punës.

²⁴ Aneksi 2.06. Plani strategjik për zhvillimin e programit.

	programi i studimit synon nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal të vendit në kuadrin e multidisiplinaritetit.		
Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm, si plani mësimor i këtij program studimi, ²⁵ ka një qasje të qartë drejt multidisiplinaritetit në fushën e arsimimit. Kurrikula ka një bazë të qëndrueshme njohurish dhe kompetencash profesionale që u mundëson studentëve të zhvillojnë dije për t’u thelluar në çështjet që përfshijnë zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e kërkimit shkencor.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2

Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit, hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Vërehet nga shqyrtimi i dokumentacionit të shfletuar se programi i studimit të ciklit të dytë Msc në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” është në harmoni të plotë me statutin ²⁶ dhe rregulloren e institucionit ²⁷ . Ai gjithashtu shpalos më së miri strategjinë për zhvillimin e institucionit, në mënyrën sesi investohet në burimet njerëzore dhe të tjera burime që institucioni ka në dispozicion, në funksion të zbatimit të stategjisë së brendshme të zhvillimit institucional.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Referuar statutit dhe rregullores së institucionit ka një ambicje të lartë në drejtim të zhvillimit të vrullshëm inovativ në të gjitha drejtimet akademike, të cilat përthyhen në kontribut në drejtim të kërkimit shkencor dhe kontributit konkret në drejtim të zgjidhjes së problematikave sociale-ekonomike të vendit. Shihet pak e paqartë mënyra sesi programi i studimit i zhvillon në brendinë e tij këto ambicje duke iu referuar konkurrencës që mund të këtë ky program studimi, i cili duhet theksuar se ofrohet edhe në institucionet të tjera publike dhe private në vend.

²⁵ Aneksi 3.04. Plani mësimorë MSHPSHE.

²⁶ Aneksi 1.01. Statuti i Kolegjit Universitar “Wisdom”.

²⁷ Aneksi 1.02. Rregullore e Kolegjit Universitar “Wisdom”.

<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Emërtimi, organizimi struktura dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me fushat e drejtimet akademik të institucionit dhe strategjisë së tij për zhvillim. Përsa i përket standarteve për unifikimin e programeve të psikologjisë ka një lehtësi në orientimin e këtij programi të profilizuar studimi në psiko-edukim, të cilat e lejojnë të konsolidohet brenda vetes fillimisht dhe nëse mund t'i referohemi edhe Urdhrit të Psikologut, plotësimi të kriterëve për marrjen e liçensës së Psikologut në përfundim të studimeve vetëm për studentët me vijimësi në të dyja ciklet e studimit në psikologji.</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Program i studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukim” është dhe zhvillohet në përputhje me strategjinë kombëtare duke respektuar vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018. “Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”²⁸. Lëndët dhe modulet e tij janë të ndara duke respektuar përqindjen e kërkuar sipas ndarjeve në kategori. Numri i krediteve të grumbulluara sipas ndarjes në semsetra dhe për çdo vit akademik gjithashtu është konform ligjit në fuqi. Gjithashtu i është dhënë një hapësirë më e madhe në planin mësimor, veprimtarive didaktiko-praktike dhe kërkimit shkencor duke iu përgjigjur në këtë mënyrë standarteve ligjore të udhëzimit Nr. 41.</p> <p><i>GVJ rekomandon institucionin të shoh mundësinë e përmirësimit të këtij programi studimi duke e përafuar me programe të tjera si motra brenda dhe jashtë vendit (referuar Europës)²⁹ duke realizuar ndërhyrje në vijimësi përgjatë viteve akademike në masën 20 % të lejuar nga ligji.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi I.3

Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

²⁸ Vendimi Nr. 41, Datë 24.1.2018. Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara.

²⁹ Lunt I., Peiró J. P., Poortinga Y., Roe R. (2014) Standards and Quality in Education for Professional Psychologists; Hogrefe.

<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” synon formimin e kompetencave dhe shprehive të nevojshme didaktiko-praktike që do t’i lejojnë studentët të orientohen lehtësisht drejt rolit të tyre profesional. Objektivat e tij janë të përcaktuar qartë në planin e tij mësimorë³⁰ përmes lëndëve të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin e kompetencave teoriko-praktike që i përgjigjen nevojave të profilit profesional. Por edhe në rregulloren e programit të studimit përcaktohen qartë objektivat akademik që synojnë t’i japin këtij program studimi të ciklit të dytë dije dhe kompetenca në drejtim të vlersimit dhe ndërhyrjes psikologjike. Kjo në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”³¹, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”³² si dhe nevojat e tregut të punës për psikolog shkollorë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni ka kryer një studim mbi tregun kombëtar të punës për programin e studimit të ciklit të dytë Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” si para hapjes së këtij program por edhe në vijimësi. Këto studime synojnë të mbajnë institucionin në kontakt të vazhdueshëm me evoluimin e kësaj fushe në tregun e punës dhe me kërkesat e reja që parashtrihen për të diplomuarit në këtë profil profesional. Një studim periodik i tregut të punës është kryer nga institucioni me qëllim vlersimin e hapsirave dhe mundësive që psikologët shkollorë dhe të edukimit kanë në institucione të ndryshme. Përmes dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucioni dhe më specifikisht analizës së tregut të punës³³ përpara hapjes së këtij program studimi si dhe një studimi periodik i tij³⁴ dhe bazuar në shqyrtimin e të dhënave nga institucione të ndryshme mbi nevojat për psikologë shkollorë dhe edukimi, është marrë vendimi i hapjes së tij. Studentët e këtij profili mund të kontribuojnë në një sërë kontekstesh profesionale përmes rolit të tyre si profesionistë të disiplinës së psiko-pedagogjisë. Nga shqyrtimi i dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucioni, si dhe më specifikisht përmes planit strategjik³⁵ të këtij programi studimi krijon pritshmëri pozitive</p>

³⁰ Aneksi 3.04. Plani mësimorë MSHPSHE.

³¹ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 08-01-2021).

³² VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr_41-date-24.1.2018.pdf (Aksesuar më 08-01-2021).

³³ Aneksi 2.21. Studim për tregun e punës përpara hapjes së programit të studimit.

³⁴ Aneksi 2.22. Studimi periodik i tregut të punës.

³⁵ Aneksi 2.06. Plani strategjik për zhvillimin e programit.

	për liçensimin e tyre dhe punësimin sipas kualifikimit në sektorin përkatës publik apo privat në vendin tonë.
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” udhëhiqet nga parimi i zhvillimit të kompetencave profesionale dhe kjo shpaloset edhe në mënyrën sesi është hartuar programi.³⁶. Gjithashtu referuar mënyrës sesi do të realizojë formimin e studentit të profilit të psikologjisë shkollore dhe të edukimit në drejtim të dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale ka një sër strukturash ku mund të mbështetet siç janë struktura mësimore³⁷ plani mësimor³⁸ i cili duhet parë si themelet e formimit profesional të studentit dhe për këtë është e rëndësishme një thellim në dije, njohuri e aftësi specifike të lidhura me rolin e psikologut shkollor dhe të edukimit. Njohuritë teorike dhe përvojat praktike do të lejojë më pas një profilizim në përputhje me prirjet, kompetencat dhe interesat profesionale të studentit. Në drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale dhe përfitimit të përvojës së praktikës profesionale³⁹, me ndikim pozitiv duhen parë si marrëveshjet e lidhura nga institucione me qendra dhe institucione të arsimit parauniversitare në vend, ku ofrohen shërbime psikologjike por edhe pasja aktive e klinikës psikologjike “Urtësia”⁴⁰ pranë KU “Wisdom” për nevojat e studentëve dhe komunitetin.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përfaqësohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Bazuar në përmbajtjen e programit lëndor dhe tipologjinë e lëndëve të formimit karakterizues dhe integruese, duke lehtësuar procesin e mobilitetit, transferimit dhe njësimit të diplomës edhe në tregun ndërkombëtar, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë⁴¹ kanë element të ngjashme me programe të tjera të ofruara nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu bazuar në programet e mobilitetit të cilat janë aktive në Bashkimin Evropian, studentët e këtij programi studimi mund të përfitojnë në drejtim të mundësive për transferim studimesh apo për punësim në tregun ndërkombëtar, me të njëjtat mundësi si për çdo institucion tjetër të arsimit të lartë në vendin tonë.</p> <p><i>Sugjerohet nga GVJ që institucioni të shoh mundësinë e përmirësimit të kurrikulës që në thelb ky program studimi përmes lëndëve dhe moduleve të synoj paisjen e studentit me njohuri dhe</i></p>

³⁶ Aneksi 3.02 Programi I studimit MSHPSHE.

³⁷ Aneksi 3.03. Struktura mësimore MSHPSHE.

³⁸ Aneksi 3.04. Plani mësimor MSHPSHE.

³⁹ Aneksi 2.32. Relacion i praktikës profesionale.

⁴⁰ Aneksi 2.27. Raporti Klinika Psikologjike “Urtësia”.

⁴¹ Aneksi 3.04. Plani mësimor MSHPSHE.

	<p><i>kompetenca që janë të ngjashme me atë që mund të marrë një student edhe nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në vend për këtë profil profesional. Kjo duke rigrupuar lëndët e përaftërta në njohuritë që japin të studentit dhe duke risjellë module me një profil më afër rolit dhe kompetencave profesionale të psikologut shkollor.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Bazuar në mungesën e përvojës në drejtim të zhvillimit të shkencës së psikologjisë në vendin tonë para viteve 90, duhet të kemi parasysh se programet lëndore tipikisht përgjatë gjithë historisë së zhvillimit të kësaj disipline janë bazuar dhe kanë evoluar duke u mbështetur në programet ndërkombëtare dhe duke marrë si model zhvillim, qasjen që këto vende kanë pasur ndaj psikologjisë. Në këtë kuadër përgjithësisht programet e studimit në këtë fushë kanë ngjashmëri, në drejtim të programit lëndorë dhe objektivave formuese e kompetencave profesionale që synojnë të zhvillojnë. Gjithashtu një sërë elementësh të strukturës së këtij program studimi si kreditet sipas Sistemit Evropian të Trasferimit të Krediteve (ECTS), kontrolli i dijeve dhe instrumentat e vlersimit, profili i programit, diploma dhe suplementi i saj etj, janë të gjithë element të pranishëm që janë në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” ofrohet me kohë të plotë, i shtrirë në dy vite akademike me kohëzgjatje normale dhe organizohet me 120 ECTS⁴². Bazuar në programin lëndorë dhe planin mësimor⁴³ të këtij programi, studentëve u mundësohet përvoja e praktikës profesionale e cila mund të kryhet në disa qendra dhe institucione publike dhe private në vend. Kjo përzgjedhje e institucioneve të praktikës profesionale u jep mundësi studentëve të zhvillojnë kompetencat profesionale, fitojnë dije praktike mbi mjetet dhe instrumentat që përdor psikologu shkollor në punën e tij. Gjithashtu ky profil i ofruar nga KU “Wisdom” është i përfshirë në grupin e profesioneve të rregulluara nga shteti, dhe u jep mundësi studentëve të licensohen te Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë. Aktivitetet ekstra kurrikulare dhe qendra e shërbimeve psikologjike “Urtësia” i japin mundësi të mira studentëve për të qenë në kontakt me përvojën e ndërhyrjes në grupmoshën e fëmijëve dhe adoleshentëve dhe mënyrën sesi ofrohen shërbimet psikologjike për palë të tjera.</p>

⁴² Aneks 3.06. ngarkesa e plotë mësimore.

⁴³ Aneksi 3.04. Plani mësimor MSHPSHE.

	Gjithashtu përmes këtyre mundësisve studentët e këtij program studimi mund të njohin më mirë terrenin e punës për psikologët shkollor, sfidat dhe vështirësitë me të cilat përballen përgjatë ushtrimit të profesionit.			
Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	Programi i studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” me kohë të plotë, i organizuar me 120 ECTS ofrohet në gjuhën shqipe. Duke iu referuar synimeve të institucionit për të përthithur student nga trojet shqiptare, procedurat dhe kriteret e pranimit lejojnë çdo student të interesuar për t’u bërë pjesë e këtij mastri shkencor. Nuk kemi evidenca për të gjykuar mbi përfshirjen e elementeve të mësimdhënies, moduleve, lëndëve në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj. Vlen të theksohet se në vendin tonë në përgjithësi programet që ofrojnë element në programin e studimit në gjuhë të huaj nuk kanë një shtritje të gjerë, në këto kushte përmbushja e këtij kriteri duhet vlersuar bazuar në kontekstin e vendit dhe avancimit të institucioneve të arsimit të lartë drejt standarteve ndërkombëtare.			
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	Referuar te dhënave të marra rezulton se ky program studimi ofrohet vetëm në gjuhën shqipe dhe si rrjedhojë edhe dokumentacioni është në këtë gjuhë. Por duhet specifikuar se suplementi i diplomës ⁴⁴ , ka element që janë të paraqitura si në shqip edhe në anglisht, gjithashtu raporti i vlersimit të brendshëm dhe një sër dokumentash të tjerë institucional janë në të dyja gjuhët shqip-anglisht ⁴⁵ . Grupi i vlersimit të jashtëm nuk ka konstatuar element të tjerë që lidhen me këtë kriter.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe	Bazuar në të dhënat e institucionit mbi stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie dhe duke iu referuar CV të tyre mund të gjykojmë

⁴⁴ Aneksi 3.09. Model suplementi i diplomës.

⁴⁵ List of general documents

<p>burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>se ky kriter pjesërisht përmbush nevojat e programit për kapacitete dhe burime konform fushës akademike specifike. Bazuar në të dhënat që grupi i vlersimit të jashtëm ka shqyrtuar⁴⁶, rezultojnë se Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej 23 pedagogë, të cilët janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 12 kanë gradën Dr., dhe 8 Asistent Lektorë me Msc. Ndërsa Departamenti i Psikologjisë ka 5 PAE dhe 3 PAK. Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik, sipas evidencës⁴⁷ rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 8 pedagogë gjithsej, ku 5 PAE, nga të cilët 1 Prof.Asoc, 4 me gradën Dr, dhe 3 PAK, 1 me titullin Prof. 1 PAK me titullin Prof.Asoc. Dr. dhe 1 me Dr. Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 rezultojnë mbi 70 %.</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi është në përputhje me kushtet dhe kriteret klasifikuese të fushës akademike kjo referuar udhëzimeve kombëtare për arsimin e lartë. Programi i studimit master i shkencave në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë, i cili është pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Të gjithë elementët përbërës të tij janë konform direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Njësia bazë që ofron këtë program studimi ka një koherencë me vizionin dhe strategjinë afatgjatë të institucionit⁴⁸ përsa i përket përputhjes me fushën akademike dhe kërkimit shkencor, si dhe është një linjë me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane. Kjo i jep mundësinë njësisë bazë, Departamentit të Psikologjisë, të ketë mundësi në rritje për zhvillimin e burimeve njerëzore në funksion të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu bazuar në klasifikimin/ kodifikimin e programit të studimit Msc në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” ky profil i ofruar nga KU “Wisdom” është në harmoni me dhe në përputhje me statutin e tij të brendshëm⁴⁹ dhe rregulloren⁵⁰ e hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet</p>

⁴⁶ Verifikime stafi akademik nga ASCAL.

⁴⁷ Listë e pedagogëve të masterit psikologji.

⁴⁸ Aneks 1.03. Plani Strategjik I Kolegjit Universitar “Wisdom”.

⁴⁹ Aneks 1.01. Statuti I Kolegjit Universitar “Wisdom”.

⁵⁰ Aneks 1.02. Rregullore e Kolegjit Universitar “Wisdom”.

	e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë ⁵¹ ; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ⁵² .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Standardi I.5				
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Institucionit vërehet të ketë një hierarki të strukturuar sipas hallkave ^{53, 54, 55, 56} të cilat monitorojnë përmes mekanizmave të saj mbarëvajtjen e punës në drejtim të realizimit të detyrave nga ana e personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Njësia bazë përmes strukturave të saj kordinatori i programit të studimit ⁵⁷ , grupit mësimorë mbikëqyrin, monitorojnë dhe bashkëpunojnë midis tyre për qëllime të mbarëvajtjes të procesit mësimor për këtë program studimi. Një sër dokumentash e përligjin bashkëpunimin brenda institucionit përmes ndarjes së detyrave mes njësive e personelit. Kjo vërehet duke iu referuar edhe dokumentacionit vënë në dispozicion mbi organizimin dhe funksionimin e departamentit ⁵⁸ , rregullorja mësimore e programit të studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” e sekretaria mësimore.			
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë	Grupi i vlersimit të jashtëm nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga KU “Wisdom” dhe të konfirmuar në takimet e zhvilluara me drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë por edhe nga studentët, kemi praninë e një sër marrëveshjes institucionale ⁵⁹ të lidhura me institucione brenda vendit. Vlen të			

⁵¹Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 08-01-2021).

⁵²VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>(Aksesuar më 08-01-2021).

⁵³ Aneksi 1.01. Statuti I Kolegjit Universitar “Wisdom”.

⁵⁴ Aneksi 1.02. Rregullore e Kolegjit Universitar “Wisdom”.

⁵⁵ Aneksi 1.06. Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

⁵⁶ Aneksi 1.08. Rregullore e ZBNJKKJS.

⁵⁷ Aneksi 2.19. Vendim për emërimin e kordinatorit të programit të studimit.

⁵⁸ Aneksi 2.07. Rregullore e Dep. Psikologji.

⁵⁹ Aneksi 2.22. Studimi periodik i tregut të punës.

<p>vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>theksohet edhe shfrytëzimi i këtyre marrëveshjeve për qëllime të praktikave profesionale dhe mundësive për mobilitet të studentëve. Marrëveshjet e bashkëpunimit të KU “Wisdom” me institucionet homologe jasht vendit janë kthyer në aplikative në aktivitetet e përbashkëta të ndërmara drejtim të kërkimit shkencor si konferencat, workshop-et, leksionet e hapura të zhvilluara pranë këtij institucioni^{60,61,62}. Në bazë të këtyre evidencave gjykohet se kjo klimë ka impakt pozitiv dhe në realizimin e objektivave të proçesit mësimor e formues të studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Në funksion të praktikës profesionale institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi⁶³. Këto marrëveshje me disa institucione kyçe për profilin e psikologut shkollor dhe të Edukimit si ‘Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë’, apo qendra që ofrojnë shërbime psikologjike në kontekstin shkollorë dhe të edukimit⁶⁴ si Drejtoria Arsimore Tiranë, Kopshti “Yje”, Qendra e Zhvillimit të Fëmijëve Tiranë, Fondacioni Klinika Psikologjike “Urtësia”, Shërbimi Social Shtetëror etj, krijojnë mundësi shumë të mirë jo vetëm në drejtim të realizimit të praktikave profesionale por edhe në krijimin e mundësive për të realizuar eksperiencë pune vulnetare. Përvoja praktike në terrenin e punës krijon mundësi për njohjen reale të mjediseve të ndryshme profesionale në fushën e psikologjisë shkollorë dhe të edukimit. E gjithë kjo përkthehet në mundësi për studentët për të njohur rolin dhe detyrat e psikologut në kontekste të ndryshme profesionale.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit institucional që KU “Wisdom” ka nënshkruar për qëllime të zhvillimit të praktikës, shkëmbimit të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore⁶⁵ janë faktor kyçe për profilin e psikologut shkollor dhe të edukimit. Institucione si Drejtoria Arsimore Tiranë, Kopshti “Yje”, Qendra e Zhvillimit të Fëmijëve Tiranë, Fondacioni Klinika Psikologjike “Urtësia”, Shërbimi Social Shtetëror, Shkolla 9 - vjeçare dhe e mesme “Kristaq Rama” etj, krijojnë mundësi shumë të mirë jo vetëm në drejtim të realizimit të praktikave profesionale por edhe në krijimin e hapsirave për të realizuar eksperiencë pune vulnetare apo punë sipas nevojave të institucioneve që ofrojnë</p>

⁶⁰ Aneksi 2.56. Relacion i përfshirjes së stafit në projekte.

⁶¹ Aneks 2.74 Ftesë dhe Relacion Prof. Dr. Emilija Stoimenova Canevska.

⁶² Aneks 2.75. Relacion leksion me Dr. Marija Stojanova.

⁶³ Aneksi 4.07. Raporti I përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

⁶⁴ Aneksi 4.09. Tabela e institucioneve bashkëpunuese.

⁶⁵ Aneks 4.08. Të dhëna për kërkimin shkencor.

	shërbimeve psikologjike për fëmijët dhe adoleshentët në kontekstin shkollorë.			
Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.	Bazuar në të dhënat e njësisë kryesore lidhur me zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve përgjatë vitit 2019-2020 ⁶⁶ , kemi një sër aktivitetesh si leksione të hapura me professor të ftuar vendas dhe të huaj, workshop-e, konferenca, projekte të zbatuara në shkallë departamenti, aktivitete shkencore të organizuara nga departamenti që janë me përfitim për stafin dhe studentët e programit të studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”. Gjithashtu në drejtimin e trajnimeve profesionale të ofruara për stafin e KU “Wisdom”, studentët dhe alumnit (ish student) kanë marrë pjesë në aktivitetin të financuar nga Erasmus + me professor të ftuar në KU “Wisdom” ⁶⁷ .			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Njësia bazë përmes strukturave të saj monitoron në vijimësi ecurinë e përgjithshme të programit të studimit përmes disa formave monitoruese si plani i punës i departamentit ⁶⁸ , analiza e punës së departamentit të psikologjisë ⁶⁹ dhe analiza e raportit të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit ⁷⁰ për programin e studimit të ciklit të dytë në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” për monitorimin e cilësisë së veprimtarive teoriko-didaktike dhe praktike që ofrohen prej saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për	Nga dokumentacioni në dispozicion rezulton se politikat institucionale të KU “Wisdom” mbështesin stafin në përfshirjen në

⁶⁶ Aneksi 2.56. Relacion i përfshirjes së stafit në projekte.

⁶⁷ Aneksi 4.07. Raporti i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

⁶⁸ Aneks 2.10. Plani i punës së departamentit të psikologjisë.

⁶⁹ Aneks 2.12. Analizë vjetore e departamentit të psikologjisë 2019-2020.

⁷⁰ Aneksi 4.07. Raporti i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

<p>publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>një sër projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor⁷¹. Bazuar në relacionin për mbështetjen e stafit akademik kemi një sër nismash që synojnë të krijojnë mundësi për pjesmarrje në konferenca apo publikime në revista ndërkombëtare⁷². Mbështetja e stafit lidhur me mobilitetin në mësimdhënie përmes Erasmus + etj. Këto lloj mobilitetesh kanë impact pozitiv jo vetëm tek stafi akademik por edhe në rritjen e aseteve të burimeve njëjërëzore të vet KU' Wisdom" dhe të studentëve të saj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni në funksion të vlerësimit të ecurisë së rezultateve në fushën e kërkimit shkencor ka ngritur institutin për kërkim dhe zhvillim "Wisdom". Ky institut ka implementuar një sër projektesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar⁷³. Në realizimin e këtyre projekteve janë përfshirë pedagogë të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Kjo njësi e kërkimit shkencorë është përfshirë në 6 projekte, nga të cilat një pjesë e tyre janë ndërkombëtare dhe të financuara nga Bashkimi Evropian.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Në kuadër të një politike promovuese të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, institucioni ka ndërmarrë një sër inisiativash që synojnë promovimin e rezultateve të kërkimit shkencor në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, leksioneve të hapura me lektorë të ftuar, dhe mbështetjen e stafit për mobilitet të pedagogëve të Njësisë së Kërkimit Shkencor. Këto veprimtari të përvitshme të organizuara nga KU "Wisdom" janë një inisiativë e mirë jo vetëm për stafin akademik por edhe për studentët pjesmarrës në këto aktivitete, duke qenë se kanë mundësi të bien në kontakt me risitë e zhvillimit të fushës dhe ballafaqimin me kompleksitetin e dinamikave të zhvillimit të shoqërisë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Krahas fondeve për organizim konferencash, workshop, leksion të hapur apo mobilitet të stafit në mësimdhënie⁷⁴, institucioni është përpjekur t'i jap prioritet edhe aspektit të mbështetjes financiare të pedagogëve të njësisë së kërkimit shkencor dhe marrdhënieve me jasht për botime në revistën shkencore "Wisdom" apo revista të tjera shkencore të huaja⁷⁵.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen</p>	<p>Përfshirja e institucionit në projekte të ndryshme rrit mundësinë për stafin dhe studentët të angaxhohen në aktivitete specifike përgjatë</p>

⁷¹ Aneks 2.56. Relacion i përfshirjes së stafit në projekte.

⁷² Aneks 2.67. Relacion mbi mbështetjen e personelit akademik.

⁷³ Aneks 2.56. Relacion i përfshirjes së stafit në projekte.

⁷⁴ Aneksi 2.56. Relacion i përfshirjes së stafit në projekte.

⁷⁵ Aneks 4.07. Propozim dhe vendim për fondin e kërkimit shkencor.

e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	aplikimit të projektit ⁷⁶ . Në kuadër edhe të provimit final të diplomës, studentët janë angazhuar në projektet e tyre kërkimore nën monitorimin e një anëtari të stafit akademik. Kërkues të rinj të cilët janë pjesë e stafit efektiv janë përfshirë në një sër projektesh dhe mobilitetesh që vlen të theksohet si element me ndikim pozitiv si në zhvillimin e fushës së kërkimit shkencorë por edhe të mësimdhënies e mësimnxënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Msc në “Psikologji Shkolllore dhe Edukimi” është hartuar në harmoni me legjislacionin vendas siç janë: Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ⁷⁷ dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ⁷⁸ dhe duke respektuar Sistemin Evropian të Trasferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS) ⁷⁹ . Kemi balancë në ndarje të lëndëve në lëndë të

⁷⁶ Aneks 4.08. Të dhënat për kërkimin shkencor.

⁷⁷ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri” https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI80-2015-PER-ARSIMIN+E-LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 08-01-2021).

⁷⁸ VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 08-01-2021).

⁷⁹ Aneks 3.04. Plani mësimor e MSHPSHE.

	<p>formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmblylëse sipas udhëzimeve të MASR. Programi i studimit Msc në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” realizohet me 120 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tij është 2 vite akademike, i ndarë në katër semestra me peshën e fitimit të 30 krediteve për semestër⁸⁰. Në përfundim të programit të studimit Msc në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” lëshohet diploma “Master i Shkencave” në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”⁸¹.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit Msc në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” përmes moduleve⁸² dhe lëndëve⁸³ synon të formojë shprehi dhe kompetenca në drejtim të vlersimit dhe ndërhyrjes në kontekstin shkollor. Kjo në një llojshmëri të gjerë rolesh profesionale si psikolog shkollor si në drejtim të zhvillimit të shprehive profesionale për të punuar me fëmijët dhe adoleshentët, me klientët të cilët kanë probleme të shëndetit mendor, por gjithashtu edhe si këshilluese në institucione rezidenciale ku marrin shërbime kategori të fëmijëve me nevoja të veçanta. Pikërisht rritja e diapazonit të mundësive që u krijohen studentëve në fushën profesionale mund të konsiderohet si pikë e fortë e këtij program studimi për të pasur më të lehtë orientimin e studentëve në tregun e punës por edhe drejt vetëpunësimit të tyre. Vetpunësimi është i mundur vetëm pas liçensimit, por formimi akademik përmbush kriteret e udhërit të psikologut për liçensim të studentëve të këtij program studimi pas marrjes së diplomës për të gjithë ata student që kanë të dy ciklet e studimit në fushën e psikologjisë.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Referuar këtij kriteri mund të themi se përmbajtja e programeve lëndore dhe literatura e përdorur janë dy elementë të rëndësishëm në drejtim të njohurive të përparuar për këtë fushë studimi dhe më tej në drejtim të zhvillimit të kompetencave shkencore dhe profesionale të studentëve. Përmbajtja e programit të studimit krijon kushte për zhvillim kompetencash profesionale dhe kërkimit shkencor nëse i referohemi emërtimit të lëndëve mësimore. Gjithsesi njësia bazë duhet të mbështetet stafin me infrastrukturën e duhur me tekste fizike që mund të aksesohen lirisht nga stafi dhe studentët. Pavarisht faktit që institucioni ka askese në disa platforma elektronike të literaturës, kjo nuk garanton në të gjitha</p>

⁸⁰ ANEKS 3.03. Struktura mësimore MSHPSHE.

⁸¹ ANEKS 3.08. Model i diplomës.

⁸² Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

⁸³ Aneks 3.04. Plani mësimor e MSHPSHE.

	<p>rastet publikime cilësore dhe akses në revista e libra me indeks të lartë.</p> <p><i>GVJ del me këto rekomandime të përgjithsme për këtë kriter:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>njësia bazë duhet të mbështes stafin me infrastrukturë në tekste fizike në bibliotekë;</i> - <i>impenjim më i madh i stafit për të përditësuar literaturën bazë me botime të 5 viteve të fundit;</i> - <i>kujdes në drejtim të mospërsëritjes të së njëjtës literaturë në lëndë të ndryshme, pasi disa lëndë kanë të njëjtat libra të përdorura në silabuset e lëndëve;</i> - <i>stafi akademik të tregoj kujdes në përzgjedhjen e literaturës në linjë me emërtimin e lëndës mësimore;</i>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Msc në “Psikologji Shkolllore dhe Edukimi” është konform pritshmërive të studentëve për të zhvilluar kompetencat e tyre si kërkues shkencor dhe ato profesionale në drejtim të njohurive teoriko-praktike për të punuar si psikolog shkollor dhe edukimi pas përfundimit të masterit. Gjithashtu drejtimi i secilës lëndë përmban një sër veprimtarish didaktiko-praktike që realizohen si pjesë e seminareve duke lehtësuar në këtë mënyrë përvetësimin praktik të koncepteve teorike nga ana e studentit. Përvoja e praktikës profesionale është organizuar në mënyrë që t’u jap mundësi studentëve të përfitojnë kompetenca dhe njohuri praktike nga prekja e terrenit të punës.</p> <p><i>GVJ del me këto rekomandime të përgjithsme për këtë kriter sugjerohet një angazhim i vazhdueshëm i stafit akademik në përditësimin e literaturës me publikime cilësore lidhur me fushën specifike të specializimit të këtij profili profesional, duke treguar kujdes në përzgjedhjen e literaturës që i përshkruan programin të studimit të ciklit të dytë dhe jo të rrezikohet përsëritja e të njëjtës literature e cila mund të jetë ezauruar përgjatë ciklit të parë të studimeve⁸⁴.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të</p>	<p>Syllabuset e Msc në “Psikologji Shkolllore dhe Edukimi” janë konform modelit të përcaktuar nga MASR në shtojcën e vendimit Nr. 41, datë 24.1.2018. “Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Syllabuset e secilës lëndë janë të organzuara sipas strukturës së më poshtë me: përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, objektivat dhe konceptet</p>

⁸⁴ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

<p>përcaktuara në akte ligjore e nënljore.</p>	<p>themelore, temat e lëndës dhe secila prej tyre përmbajnë një sër veprimtarishë praktike që realizohen si pjesë e seminareve duke lehtësuar në këtë mënyrë përvetësimin e koncepteve teorike nga ana e studentit. Syllabusi i praktikës është organizuar në mënyrë që t'u jap mundësi studentëve të përfitojnë kompetenca dhe njohuri praktike nga prekja e terrenit të punës si dhe duke shërbyer si një opsion për lehtësira në drejtim të realizimit të kërkimit shkencor në njërin prej institucioneve pritëse.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimore janë konform ligjit për arsimin e lartë⁸⁵ dhe urdhrave⁸⁶ duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 7 % (8 ECTS); - Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 58 % (70 ECTS); - Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore / Integruese 10 % (12 ECTS); - Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (12 ECTS); - Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 15 % (18 ECTS); <p>Ky program studimi respekton të gjitha kriteret përta i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara sipas Vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018)⁸⁷, duke respektuar numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënljore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Ky program studimi i ciklit të dytë respekton të gjitha kriteret përta i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara sipas Vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018)⁸⁸, duke respektuar numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënljore në fuqi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të shqyrtuar nga GVJ evidentohet se ky program studimi parashikon për realizimin e diplomës dhe aktiviteteve kërkimore 150 orë të zhvilluara në auditor dhe 300 orë punë individuale e pavarur e studentit, pra 450 orë pune në total që korrespondojnë me 18 kredite CTS (1 kredit=5 orë).</p>

⁸⁵ Ligji nr 802015 Për Arsimin e Lartë.

⁸⁶ Vendimi për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Msc. Psikologji Shkollore dhe Edukimi”, Kolegji Universitar Wisdom.

⁸⁷ VKM nr 41, datë 24.01.2018. Për elementët e programeve të studimit.

⁸⁸ VKM nr 41, datë 24.01.2018. Për elementët e programeve të studimit.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, si njësi kryesore e organizuar sipas ligjeve për organizimin akademik dhe administrative të institucioneve të arsimit të lartë ka si pjesë të saj njësinë bazë përgjegjëse, Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme. Mësohet nga takimi me përgjegjësen e Departamentit dhe antarë të departamentit se njësia bazë ngre grupin e vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi sipas detyrimeve ligjore për funksionimin normal të tij, si dhe në linjë me statutin dhe rregulloren e institucionit. Kjo njësi përmbush kushtet për vijimin e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi, duke iu referuar ndjekjes së procedurës pranë ASCAL duke respektuar ligjet në fuqi.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Mënyra si funksionon njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë” sipas propozimit të përgjegjësit të Departamentit miraton në rolin e kordinatorit për këtë program studimi Dr. E. Sh. ⁸⁹ . Njësia kryesore është organizuar në 2 departamente dhe 1 njësi të kërkimit shkencor dhe të marrëdhënieve me jashtë. Njësia bazë që e ofron Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” është Departamenti i Psikologjisë, i cili është pjesë e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis	Bazuar në të dhënat e njësisë kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë MSc në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”, institucioni përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie. Duke iu referuar CV të tyre mund të gjykojmë se ky kriter pjesërisht përmbush nevojat e programit për kapacitete dhe burime konform fushës akademike specifike.

⁸⁹ Aneks 2.19. Vendim për emërimin e kordinatorit të programit të studimit.

<p>personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Bazuar në të dhënat që grupi i vlerësimit të jashtëm ka shqyrtuar⁹⁰, rezulton se Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore për vitin akademik 2020-2021 ka gjithsej 31 pedagogë, nga të cilët 24 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 12 kanë gradën Dr./PhD, dhe 9 Asistent Lektorë me Msc; dhe 7 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 1 ka titullin “Profesor”, 2 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 3 kanë gradën Dr./PhD. dhe 1 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Psikologjisë ka 7 PAE, nga ku: 1 ka titullin “Profesorë i Asociuar”, 4 kanë gradën Dr./PhD, dhe 2 Asistent Lektorë me Msc dhe 4 PAK, nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 1 ka titullin “Profesorë i Asociuar”, 1 ka gradën Dr./PhD, dhe 1 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik, sipas evidencës⁹¹ rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 8 pedagogë gjithsej, ku 5 PAE, nga të cilët 1 Prof.Asoc, 4 me gradën Dr, dhe 3 PAK nga ku 1 me titullin Prof., 1 me titullin Prof.Asoc. dhe 1 me gradën Dr.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 është 62.5% / 37.5.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Psikologjisë ka një hierarki në mënyrën e funksionimit të tij dhe kjo konform udhëzimeve të MASR dhe konform rregullave që monitorojnë aspektin e ligjshmërisë. Referuar të dhënave⁹²stafi akademik i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme që është përgjegjës për programin e studimit për dy vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë⁹³:</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, (4 PAE/ 3 PAK), nga këta të gjithë janë me grada/tituj shkencore; Për vitin akademik 2020-2021, (5 PAE / 3 PAK) nga këta me grada/tituj shkencore 8; Në vitin akademik 2020-2021 në funksion të organizimit dhe strukturës akademike janë angazhuar 5 anëtarë të personelit akademik efektiv, ku të gjithë janë me grada dhe tituj. Ngarkesa e orëve në auditor e mbuluar përmes personelit akademik efektiv kalon masën 70% referuar minimumit të kërkuar nga aktet ligjore, dhe përmbush strukturën akademike. Kjo evidencë na lejon krijimin e një</p>

⁹⁰ Verifikime stafi akademik nga ASCAL.

⁹¹ Listë e pedagogëve të masterit psikologji.

⁹² Aneks 2.95. Të dhëna tabelore për personelin akademik të njësisë.

⁹³ Aneks 2.94. Të dhëna tabelore për personelin akademik.

	panorame të qartë të situatës për periudhën aktuale dhe projektimin e saj në vijimësinë e këtij programi studimi.
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	Përvoja praktike ka një infrastrukturë që i lejon të jetë efikase në raport me përvetësimin e njohurive praktike si rrjedhojë e kordinimit të mirë që njësia bazë ka bërë në drejtim të marrëveshjeve institucionale për nevojat e praktikës profesionale për këtë program studimi dhe të monitorimit nga pedagogu udhëheqësi i praktikës. Nevoja për të qenë të trajnuar në mënyrë të përshtatshme në lidhje me ofrimin e shërbimeve psikologjike personave që u përkasin kategorive vulnerabël të cilët e kanë të pamundur të përballen me problemet e shëndetit mendor, vështirësitë në të nxënë, praktikave të përshtatshme të edukimit, përbëjnë një kusht të domosdoshëm për këtë program studimi. Përvoja praktike ka një infrastrukturë që i lejon të jetë efikase në raport me përvetësimin e njohurive praktike si rrjedhojë e kordinimit të mirë që njësia bazë ka bërë në drejtim të marrëveshjeve institucionale për nevojat e praktikës profesionale për këtë program studimi dhe të monitorimit nga pedagogu udhëheqësi i praktikës. Nevoja për të qenë të trajnuar në mënyrë të përshtatshme në lidhje me ofrimin e shërbimeve psikologjike personave që u përkasin kategorive vulnerabël të cilët e kanë të pamundur të përballen me problemet e shëndetit mendor, përbëjnë një kusht të domosdoshëm për këtë program studimi
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Mënyra si funksionon njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë”, sipas propozimit të përgjegjësit të Departamentit miraton në rolin e kordinatorit për këtë program studimi Dr. E. Sh. ⁹⁴ . Përgjegjësitë e kordinatorit të programit të studimit Msc. në “Psikologji Shkolllore dhe Edukimi” rregullohen edhe përmes objektivave formuese të programit të lëndës ⁹⁵ . Roli i kordinatorit lehtëson në aksesin e informacionit për studentët dhe për pedagogun e praktikës në lidhje me terenet e mundshme të shfrytëzueshme nga studentët e këtij program studimi për praktikën profesionale por edhe përmes angazhimit të studentëve në një sër aktivitetesh ekstrakurrikulare të organizuara në rang departamenti apo fakulteti.

⁹⁴ Aneks 2.19. Vendim për emërimin e kordinatorit të programit të studimit.

⁹⁵ Aneks 2.20. Model relacioni i koordinitorit të programit të studimit.

<p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Koordinatori i programit referuar informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion realizohet në vijimësi. Ai raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse. Në lidhje me çdo informacion që lidhet me programin e studimit në dispozicion kemi relacionin që kordinatori bën me shkrim lidhur me procesin mësimorë dhe mënyrën e realizimit të tij nga cdo pedagog. Koordinator i programit raporton⁹⁶ në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.3 Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionin e nevojshëm për organizimin⁹⁷, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Nga takimet me dekanin e institucionit, përgjegjësen e departamentit dhe zyrat përkatëse të ZBNj apo edhe ZNjSBC, mësohet se protokollat e institucionit dhe burimet njerëzore e materiale në funksion të organizimit të këtij programi studimi⁹⁸ duket se i japin mundësi institucionit të avancojë në drejtim të realizimit të tij konform rregullave që i lejojnë funksionimin normal.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” është organizuar konform rregullores së programit dhe përcaktimeve ligjore në fuqi duke respektuar ndarjen e veprimtarive formuese sipas tipit të komponentëve mësimor në kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese (praktika) dhe detyrime përmbyllëse. Departamenti i Psikologjisë ka një hierarki në mënyrën e</p>

⁹⁶ Aneks 2.20. Model relacioni i koordinatorit të programit të studimit.

⁹⁷ Aneks 2.31. Udhëzuesi Didaktik.

⁹⁸ Aneks 2.33. Rregullore e transferimeve.

	funksionimit të tij dhe kjo konform udhëzimeve të MASR dhe konform rregullave që monitorojnë aspektin e ligjshmërisë.
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Përsa i përket përmbytjes së planit mësimor ai është në harmoni me Vendimin Nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” në drejtim të krediteve sipas ECTS-së, dhe respektimit të standarit për shpërndarjen e krediteve në çdo semestër përgjatë 1 viti akademik, një balancë e ngjashme është respektuar edhe në shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimorë janë konform ligjit për arsimin e lartë⁹⁹ dhe urdhrave¹⁰⁰ duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë: - Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 7 % (8 ECTS); - Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 58 % (70 ECTS); - Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisiplinore / Integruese 10 % (12 ECTS); - Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (12 ECTS); - Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 15 % (18 ECTS).
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit MSc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” respekton të gjitha kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara me ligji (Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018)¹⁰¹, duke respektuar numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ky program studimi ka një informacion të detajuar konform rregullave në fuqi dhe një shpërndarje të qartë të planit mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, kreditet dhe ndarjen sipas</p>

⁹⁹ Ligji nr 802015 Për Arsimin e Lartë.

¹⁰⁰ Vendimi për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Msc. Psikologji Shkollore dhe Edukimi”, Kolegji Universitar Wisdom.

¹⁰¹ VKM nr 41, datë 24.01.2018. Për elementët e programeve të studimit.

	semestrave akademike. Në funksion të këtij procesi është dhe rregullorja e këtij program studimi, në të cilën specifikohen rregullat e frekuentimit të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlersimit të dijeve.
Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	KU “Wisdom” ka të specifikuar në rregulloren mësimore për programin e ciklit të dytë të studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” kriteret që duhet të plotësohen për t’u pranuar në programin e studimit. Kjo rregullore mësimore e programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Institucioni përmes njësive të saj monitoron respektimin e kriterëve të përgjithshme dhe specifike ¹⁰² të pranimit në këtë program studimi si dhe procedurat e ndjekura në pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e programit të studimit bazuar në rregulloren e rregjistrimeve dhe transferimeve të KU “Wisdom” ¹⁰³ .
Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet lëndore përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018” ¹⁰⁴ , gjithashtu duke iu referuar planit mësimorë ¹⁰⁵ , kemi një ndarje të lëndëve mësimore në semestra duke respektuar peshën e ngarkesës në semestra dhe duke ruajtur numrin e krediteve për çdo semestër akademik. Lidhur me procedurat që ndjek institucioni në drejtim të realizimit të programit të studimit kemi një informacion të pasur me të dhëna që rregullojnë punën në drejtim të hartimit të syllabuseve të lëndëve sipas ligjeve shtetërore dhe sipas formatit të miratuar nga MASR, dhe i njëjti drejtim ndiqet edhe nga rregullorja mësimore e programit të studimit, e cila përcakton parimet e përgjithshme për këtë program studimi.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	Përsa i përket programit të studimit Msc në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” ky program është gjithmonë në përmirësim të vazhdueshëm përmes përmirësimit të planeve mësimore çdo vit akademik dhe miratimit të tyre nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Mbetet të shohim stabilizimin tij në linjë me kërkesat e një arsimit cilësor dhe në funksion të zhvillimit të kompetencave profesionale që i mundëson studentit të avancojnë në fushë. Duke iu referuar të

¹⁰²II. 4. Rregullorja e programit të studimit Master Profesional

¹⁰³ Annex 5.08. Regulation of the study program.

¹⁰⁴VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr_41-date-24.1.2018.pdf (Aksesuar më 08-01-2021).

¹⁰⁵ Aneks 3.04. Plani mësimor e MSHPSHE.

dhënave që u shqyrtuan nga GVJ, në programin e lëndëve evidentohen disa të dhëna kontradiktore përsa i përket stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni rezulton se ngarkesa mësimore që mbulohet nga stafi akademik me kohë të plotë është në masën mbi 70 %. Të dhënat për disa dokumenta kryesore janë edhe në anglisht.

Rekomandohet nga GVJ të angazhohet në përmirësimin e kurrikulës:

- *Përsa i përket disa lëndëve të përfaqësuara si "Psikologjia e fëmijëve me nevoja speciale"(lëndë e detytuar), "Çrregullimet autistike dhe trajtimi i tyre"(lëndë me zgjedhje), "Çrregullimet e të nxënësve"(lëndë me zgjedhje), të cilat mund të grupohen në një lëndë të vetme, duke qenë së njohuritë që synojnë të japin janë të ngjashme. Pra lëndët me zgjedhje të përfshihen në lëndën e detytuar dhe mbetet hapësirë për të plotësuar edhe boshllëqe të kurrikulës për t'u plotësuar me njohuri të tjera të nevojshme për psikologun shkollor;*

Të rivlersohet mundësia e mospërfshirjes së lëndës mësimore "Cështje të psikolinguistikës" në këtë program studimi pasi është një lëndë që nuk i nevojitet detyrimisht një psikologu shkollor dhe kreditet e saj mund të zëvendësohen me një tjetër lëndë të nevojshme;

- *Të rivlersohet emërtimi dhe fokusi i lëndës "Psikologji e komunikimit klinik me fëmijët dhe adoleshentët" për të qenë më pranë rolit dhe kompetencave të një psikologu shkollor, duke ia dhënë fokusin drejt këshillimit në kontekstin shkollor;*
- *Gjithashtu, lëndët Psikologjia shkollore e zbatuar (lëndë e detyruar në vitin e parë të studimeve) të kalojë në vitin e dytë dhe të shkëmbehet me lëndën "Teoritë dhe modelet e mësimdhënies" (lëndë e vitit të dytë të masterit shkencor); ky sugjerim i nevojshëm për rrjedhën logjike dhe përfundimin më të mirë të studentëve nga këto dy lëndë që janë në vijimësi me njëra-tjetrën.*

Shkalla e përmbushjes së standardit

Niveli	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit të ciklit të dytë Msc. në “Psikologji Shkollor dhe Edukimi” reflekton një koherencë me parashikimet e akteve ligjore referuar numrit të krediteve, 60 kredite, kohëzgjatjes normale të tij në 2 vite akademike, tipologjisë së lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin duke u mbështetur në VKM.Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin ¹⁰⁶ dhe Rregulloren ¹⁰⁷ e KU “Wisdom”.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit Msc. në “Psikologji Shkollor dhe Edukimi” mbështetet në VKM Nr. 41, dt.24.01.2018, mund të krijoj kushte të favorshme në drejtim të përfitimit të njohurive, aftësive, licensimit dhe punësimit për profilin e studimit psikolog shkollor dhe edukimi, pasi përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë të arrihet një profilizim që të jep mundësi të punosh brenda fushës së psikologjisë shkollorë. Shpërndarja e lëndëve i jep mundësi studentit të marrë njohuri nga disiplina të psikologjisë shkollorë e të edukimit, praktika gjithashtu bazuar në mënyrën e organizimit dhe tematikave që prek, referuar sylabusit të lëndës ¹⁰⁸ të japin mundësi për qartësi brenda fushës shkollorë/ edukimit dhe thellim të njohurive dhe kompetencave praktike e aplikative.
Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Plani mësimor ¹⁰⁹ është në harmoni me Vendimin Nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, në drejtim të krediteve sipas ECTS-së, dhe respekton standartet për shpërndarjen e krediteve në çdo semestër përgjatë 2 viteve akademike. Një balancë e ngjashme është respektuar edhe në shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, lëndë plotësuese

¹⁰⁶ Aneks 1.01. Statuti i Kolegjit Universitar “Wisdom”.

¹⁰⁷ Aneks 1.02. Rregullore e Kolegjit Universitar “Wisdom”.

¹⁰⁸ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

¹⁰⁹ Aneks 3.04. Plani mësimor e MSHPSHE.

	dhe detyrime përmbyllëse. Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimorë janë konform ligjit për arsimin e lartë ¹¹⁰ dhe urdhrave ¹¹¹ ; ¹¹² duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite.
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Referuar të dhënave të shqyrtuara nga GVJ struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master shkencor në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë: Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 7 % (8 ECTS); Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 58 % (70 ECTS); Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore / Integruese 10 % (12 ECTS); Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (12 ECTS); Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 15 % (18 ECTS). Ky program studimi respekton të gjitha kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara me ligji (Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018)¹¹³, duke respektuar numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ky program studimi ka një koherencë në lidhje me elementët që synon të zhvillojë tek studenti në mënyrë që të lehtësojë realizimin e detyrave të kërkuar në tregun e punës për profesionin e psikologut shkollor dhe të edukimit. Gjithashtu programi përfshin element mbi zhvillimin e disa shprehive profesionale që e ndihmojnë psikologun shkollor të realizojë detyrën e tij të ofrimit të shërbimeve psikologjike në mënyrë profesionale në kontekstin shkollor. Mbështetur në disa element të rëndësishëm që kanë të bëjnë me përmbajtjen e tij gjykojmë se programi i pasqyron ato si pjesë të tij. Kemi një balancë midis mënyrës së paraqitjes së informacionit mbi ngarkesën mësimorë, ndarjen sipas semestrave, orë në auditor dhe frekuentimin, vlersimin e dijeve dhe një sër akvitetesh specifike që synojnë të mbështesin aspektin praktik të përvetësimit të dijeve të akumuluar nga studentët. Bazuar në ngjashmëritë në emërtim në planin mësimorë ky program lehtëson mobilitetin e studentëve brenda dhe jasht vendit.</p>

¹¹⁰Dokumenti 181. Ligji nr 802015 Për Arsimin e Lartë.

¹¹¹ Vendimi për hapjen e programit të studimit të cilkit të dytë të studimit, Msc. Psikologji Shkollore dhe Edukimi”, të SHLUJ Wisdom University.

¹¹² Vendimi për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Msc. Psikologji Shkollore dhe Edukimi”, Kolegji Universitar Wisdom.

¹¹³Dokumenti 184. VKM nr 41, datë 24.01.2018. Për elementët e programeve të studimit.

<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Përsa i përket programit të studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” ky program është gjithmonë në përmirësim të vazhdueshëm përmes përmirësimit të planeve mësimore çdo vit akademik dhe miratimit të tyre nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Mbetet të shohim stabilizimin e tij në linjë me kërkesat e një arsimi cilësor dhe në funksion të zhvillimit të kompetencave profesionale që i mundëson studentit të avancojnë në fushë.</p> <p>Në linjë me profilizimin, <i>GVJ sugjeron që pedagogët që mbulojnë lëndët karakterizuese të programit, të tregojnë kujdes në përzgjedhjen e literaturës së detyruar të 5 viteve të fundit, si dhe të një niveli të avancuar njohurish që u lejon studentëve të avancojnë në dijet e tyre. Një kujdes të veçantë duhet të tregohet nga stafi akademik që të mos përdoret e njëjta literaturë që mund të jetë përdorur edhe në programin bachelor në psikologji¹¹⁴.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Mënyra sesi janë ndërtuar modulet e lëndëve të japin mundësi për fitimin e shprehive shkencore dhe profesionale. Një sër aktiviteteish të formimit teorik dhe praktik të japin hapsirat e nevojshme për të përthyer në mënyrë të duhur aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme që i lejojnë psikologut shkollor dhe edukimit të zhvillojë disa kompetenca profesionale procesin e vlersimit të problemit dhe të ndërhyrjes psikologjike, të nevojshme për një vizibilitet më të madh në tregun e punës. Megjithatë ky element duhet parë në kontekstin global, pasi personeli akademik në një pjesë të rasteve, referuar syllabuseve të lëndëve mësimore¹¹⁵ përdor një literaturë jo të 5 viteve të fundit dhe që zakonisht përdoret në programin bachelor¹¹⁶, në disa raste vërehet një literaturë jo në përputhje me tipologjinë e lëndës¹¹⁷. Mënyra sesi do implemetojë në planin mësimorë të lëndës idetë inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore në mbështetje të nevojave të studentit në lidhje me avancimin në njohuri mbetet një sfidë.</p> <p><i>Për sa më sipër GVJ rekomandon, se këto evidenca kërkojnë një angazhim më të madh nga strukturat përgjegjëse të njësisë bazë, në monitorimin dhe miratimin e syllabuse të lëndëve mësimore.</i></p>

¹¹⁴ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

¹¹⁵ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

¹¹⁶ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

¹¹⁷ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

	<i>Gjithashtu një vëmëndje më e shtuar në përfshirjen e temave mësimore, të një literature të përditësuar dhe të përshtatshme për objektivat e lëndës mësimore, do të përmirësonte cilësinë në mësimnxënie dhe njohjen e këtij roli në një mënyrë më të konsoliduar nga ana e studentëve.</i>
Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nëse i referohemi planit mësimorë ¹¹⁸ kemi një ndarje të balancuar midis veprimtarive formuese të cilat zhvillohen në auditor dhe jasht tij. Këto veprimtari kanë të ndërthurura aspektet teorike dhe praktike që të lejojnë aftësimin e studentit në përvetësimin e shprehive të nevojshme për të realizuar punën konkrete gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Praktika profesionale gjithashtu mbështet plotësisht nevojat e programit shkencor për zhvillim kompetencash dhe aftësish të nevojshme për të gjetur veten lehtësisht në tregun e punës. Referuar marrëveshjeve institucionale për praktikën profesionale ¹¹⁹ , studentët kanë mundësi për të përzgjedhur institucionet e praktikës në linjë me profilin e tyre kërkimore dhe profesional, që tu shërbejnë nevojave të tyre për t'u përballur e fituar njohuri dhe përvojë në fushën e psikologjisë shkollore dhe të edukimit.
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Ky program studimi i përgjigjet më së miri nevojave aktuale të vendit por edhe nevojave të tregut kombëtar përsa i përket profesionistëve që ofrojnë shërbime psikologjike në kontekste të ndryshme profesionale në fushën e psiko-edukimit. Dinamika e zhvillimit të fëmijëve dhe adoleshenëve dhe problematikat që bashkëshoqërojnë procesin e edukimit. Kjo gjë kërkon profesionist të kualifikuar të cilët kanë kompetenca shkencore dhe profesionale për ndërhyrje në kontekstin shkollorë, për të realizuar procese vlersimi psikologjik, evidentim të problemeve të shëndetit mendor dhe ndërtimin e një plani ndërhyrje që lejon marrësit e shërbimit të përmirësojnë cilësisht jetën e tij personale, sociale dhe akademike.
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Programi mësimor dhe mënyra e ndërtimit të kurrikulës së këtij program studimit krijojnë mundësi për vijimin e zhvillimit të kompetencave shkencore e profesionale në analizën, ndërhyrjen dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në kontekstin shkollor dhe më gjerë. Ndërthurja e njohurive dhe shprehive të kërkimit shkencor me ato profesionale që synohen të përvetësohen përmes programit të studimit Msc. në "Psikologji Shkollore dhe Edukimi"

¹¹⁸ Aneks 3.04. Plani mësimor e MSHPSHE.

¹¹⁹ Aneksi 4.07. Raporti i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

	do t'i ndihmojë studentët të zotërojnë asetet e nevojshme të pritshme nga punëmarrësit e tyre.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik ¹²⁰ me kohë të plotë të angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike është si më poshtë: Për vitin akademik 2020-2021 janë të angazhuar 8 pedagogë ndër të cilët 5 PAE dhe 3 PAK .
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Mbulimi i programit në përqindje është 62.5% PAE dhe 37.5% PAK . Për vitin akademik 2019-2020 janë të angazhuar 7 pedagogë ndër të cilët 4 PAE dhe 3 PAK . Mbulimi i programit në përqindje është 57% PAE dhe 43% PAK . Për vitin akademik 2018-2019 janë të angazhuar 8 pedagogë ndër të cilët 6 PAE dhe 2 PAK . Mbulimi i programit në përqindje është 75% PAE dhe 25% PAK . Për sa i përket kualifikimeve të Personelit akademik: - Për 2020-2021, 100% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik; - Për 2019-2020, 100% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik; - Për 2018-2019, 90% e pedagogëve kanë gradë shkencore/tituj akademik, 10% janë Msc.

¹²⁰ Lista e pedagogëve të masterit psikologji.

	<p>Bazuar në këto të dhëna personeli akademik përmbush kërkesat ligjore në fuqi në lidhje me kualifikimin e tyre grada shkencore/tituj akademik. Duke iu referuar të dhënave që kemi mbi edukimin dhe kualifikimin e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi mund të thuhet se përmbushen standartet referuar titujve dhe gradave, edhe pse sugjerohet të kihet parasysh vijimësia e arsimimit të tyre brenda fushës së psikologjisë shkollore dhe të edukimit. Personeli akademik i angazhuar në procesin mësimor për vitin akademik 2020-2021¹²¹ na është vënë në dispozicion dhe referuar realizimit të këtij programi studimi stafi akademik ka kualifikimin e duhur dhe ka një përputhje mes angazhimit në mbulimin e moduleve mësimore të përafërta me fushën e tyre të kualifikimit në psikologji dhe pedagogji. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit master i shkencave në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” kanë kualifikimin e duhur në drejtim të mbulimit të moduleve mësimore në linjë me kompetencat profesionale dhe përvojën akademike.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni rezulton se ngarkesa mësimore që mbulohet nga stafi akademik me kohë të plotë është në masën mbi 70 %. Kemi një sër të dhënash lidhur me angazhimin e stafit akademik të aktivizuar në procesin mësimor në këtë program studimi. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij, kjo duke ruajtur një lloj ekuilibri në linjë me profilet e këtij masteri në njohuri dhe kompetenca në psikologji dhe edukim.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera</p>	<p>Marrëveshje e bashkëpunimit institucional¹²² që KU ‘Wisdom’ ka nënshkruar për qëllime të zhvillimit të praktikës, shkëmbimit të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore janë faktor kyç për profilin e psikologut shkollor dhe të edukimit. Institucione si ‘Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë’, apo qendra që ofrojnë shërbime psikologjike në fushën e psikologjisë shkollore dhe edukimit si “Kryqi i Kuq Shqiptar”, Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra “Jonathan” Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë, Kopshti “Yjet”, Drejtoria e Kopshteve dhe Çerdheve” etj, krijojnë mundësi shumë të mira jo vetëm në</p>

¹²¹ Aneks 3.06. Ngarkesa e plotë mësimore.

¹²² Aneks 4 .07. Raporti i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit



<p>specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>drejtim të realizimit të praktikave profesionale¹²³ por edhe në krijimin e hapsirave për të realizuar eksperiencë pune vulnetare sipas nevojave të institucioneve që ofrojnë shërbimeve psikologjike për komunitetin e shkollës. Gjithashtu kompetencat në drejtim të kërkimit shkencor duket se preken përgjatë lëndëve të ndryshme teorike që studentët zhvillojnë në auditor dhe angazhimit në detyrat e kursit. Angazhimi në punimin e diplomës është një hap i rëndësishëm në drejtim të zhvillimit të aftësive dhe dijeve në drejtim të kërkimit shkencor. Gjithashtu duket se në këtë aspekt një ndihmesë japin edhe aktivizimi pranë njësisë kryesore të një sërë aktiviteteve ekstrakurrikulare ku përfshihen studentët të cilët janë të angazhuar në nisma sociale. Mbështetur në sa më sipër mund të konkludojmë se programi i studimit ka në dispozicion një strukturë që favorizon përvetësimin e njohurive praktike në drejtim të rritjes së kompetencave kërkimore dhe profesionale të studentëve që ndjekin këtë program studimi.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter disa evidencë garantojnë angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të këtij programi studimi. Gjatë vizitës në institucion komunikimi me stafin e pranishëm në takim na dha mundësi të qartësohemi plotësisht në lidhje me këtë aspekt. Vërtetohet se ka procedurë që ndiqen nga njësitë përkatëse përgjegjëse për infrastrukturë dhe mbarëvajtjen e procesit të realizimit të orëve praktike që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

¹²³ Aneks 4.09. Tabela e institucioneve bashkëpunuese.

<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i psikologjisë konform rregullave të paracaktuara nga ligjet në fuqi dhe kjo evidentohet në statutin e KU “Wisdom”, mbështetur në rregulloren e këtij programi studimi master të ciklit të dytë Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”. Kordinimi i punës midis njësisë kryesore, asaj bazë dhe rolit të kordinatores së programit të studimit në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” krijojnë një infrastrukturë të përshtatshme për mbarëvajtjen e punës në këtë program studimi. Në drejtim të bashkëpunimit me partner nga tregu i punës ka një ndëveprim të drejtpërdrejt me profesionistët e terrenit në kontekstin e praktikës profesionale¹²⁴.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë monitoron në vijimësi përshtypjet e studentëve të këtij program studimi përmes rolit të kordinatorit të këtij program studimi, përmes pyetësorëve për studentët¹²⁵ dhe stafit akademik¹²⁶ etj. Në takimet me drejtuesit e njësisë bazë, GVJ u informua se njësia bazë organizon takime periodike me studentët për të marrë feedback-un e tyre për mënyrën e realizimit të programit mësimor dhe aspektin e realizimit të eksperiencave të praktikës profesionale pranë institucioneve me të cilat Ku “Wisdom” ka një marrëveshje. Në funksion të përmirësimit të programit të studimit, Njësia e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë në bashkëpunim me njësinë bazë organizon takime me student e pedagogë¹²⁷. Këto nisma ndihmojnë në evidentimin e çështjeve kryesore që shqetësojnë palët e ndryshme të përfshira si studentët, stafin akademik apo strukturat e tjera.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit¹²⁸ me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të ofertës së tij formative për të qenë sa më afër pritshmërive dhe kërkesave të tregut të punës. Institucioni ka ngritur njësinë e kordinimit dhe mbështetjes studentore dhe zyrës së karrierës dhe alumnit. Për të siguruar mbarëvajtjen e punës janë në dispozicion lehtësira që drejtojnë punën e personelit të anagazhuar në këto drejtime dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>

¹²⁴ Aneks 4.07. Raporti i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

¹²⁵ Aneks 2.36. Model pyetësori i studentëve.

¹²⁶ Aneks 2.39. Relacion i pyetësorit të stafit akademik.

¹²⁷ Aneks 2.40. Relacion takimi i departamentit të psikologjisë me studentët.

¹²⁸ Aneks 2.60. Axhenda dhe relacioni takimit me Alumnin.

	Mbështetja e kësaj zyre nga projekte dhe institucione të ndryshme lejojnë njësinë të përshtas programin me nevojat e tregut të punës, gjithashtu përmes udhëzimit për zhvillimin e karrierës ¹²⁹ .			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj, institucioni ka realizuar një sër veprimtarish kërkimore- shkencore. Bazuar në realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare për vitin 2019-2020 ¹³⁰ , kemi praninë e një sër aktiviteteve si trajnime, workshop-ve apo tryeza të rumbullakta të realizuara me institucione publike e private kombëtare dhe ndërkombëtare, konferenca e leksione të hapura. Këto aktivitete janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit institucional që KU “Wisdom” ka nënshkruar për qëllime të zhvillimit të praktikës, shkëmbimit të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore. Institucione si ‘Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë’, apo qendra që ofrojnë shërbime psikologjike në fushën e psikologjisë shkollore dhe edukimit si “Kryqi i Kuq Shqiptar”, Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra “Jonathan” Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë, Kopshti “Yjet”, Drejtoria e Kopshteve dhe Çerdheve” etj,			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” ka një linjë të qartë në drjetimin e psiko-pedagogjisë duke qenë aktiv në realizimin e një sër veprimtarish në këtë fushë, konform kompetencave të fituara në kërkim dhe shprehi profesionale. Ky program studimi u jep mundësi studentëve të avancojnë në drejtim të kualifikimeve të tyre në ciklin e tretë të studimit pas përmbylljes së këtij program studimi. Gjithashtu referuar edhe vizionit të masterit, ky përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit duke kanalizuar profilin e psikologut shkollor dhe të

¹²⁹ Aneks 2.59. Relacion takimi i departamentit me institucionet.

¹³⁰ Aneks 4.07. Raporti I përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

	edukimit në një shumëllojshmëri rolesh profesionale brenda kontekstit shkollorë.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia kryesore/bazë nxit dhe ka një rol aktiv në drejtim të bashkërendimit dhe administrimit të veprimtarive në mësimdhënie ¹³¹ . Në këtë aspekt janë ndërmarrë një sër nismash që kanë ndikim pozivitet si në zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik por edhe tek studentët e këtij program studimit ¹³² . Nga evidencat shihen shëmbuj të mirë të mbështetjes së stafit akademik në pjesmarrje të stafit në veprimtaritë kërkimore shkencore ¹³³ dhe projekte kombëtare e ndërkombëtare ¹³⁴ . Mënyra e realizimit të procesit mësimor dhe autonomia që secili pedagog ka në drejtim të realizimit të programit mësimor të lëndës së tij kryhen duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit të ciklit të dytë i mundëson studentëve të angazhohen në veprimtari që nxisin mendimin kritik dhe refleksionin personal mbi një sër çështje e fenomene që evidentohen në kontekstin shkollor. Gjithashtu vlen të theksohet se lëndë të veçanta kanë të përfshira edhe detyrat e kursit në të cilat studentët fillojnë të zhvillojnë aftësi në drejtim të hulumtimeve që bazohen tek shqyrtimi i literaturës. Konferencat studentore të përvitshme ¹³⁵ shërbejnë si mjet për nxitjen dhe motivimin e studentëve të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore ¹³⁶ .
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Bazuar në angazhimet e stafit akademik dhe të institucionit KU “Wisdom” në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare janë element që ndikojnë pozitivisht në drejtim të plotësimit të këtij kriteri. Roli i tyre në këto projekte ka për qëllim kryesor zgjerimin, thellimin, zbatimin e njohurive shkencore mbi fenomenet e studiuara në planin e rritjes së cilësisë në mësimdhënie e në drejtim të kërkimit shkencor ¹³⁷ . Programi i studimit Msc. në “Psikologji Shkollorë dhe Edukimi” përfiton nga veprimtaritë e ndërmarrë nga institucioni në kuadër të zhvillimit të një sër projektesh ^{138, 139, 140, 141} fokusohet në

¹³¹ Aneksi 1.11. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit.

¹³² Aneksi 2.06. Plani strategjik për zhvillimin e programit.

¹³³ Aneksi 267. Relacion mbi mbështetjen e personelit akademik.

¹³⁴ Aneksi 2.81. Aplikim dhe pranim për mobility project me Split.

¹³⁵ Aneksi 2.61. Axhenda e konferencës studentore “Sfidat e reja në psikologjinë dhe ekonominë modërn”.

¹³⁶ Aneksi 2.62. Axhenda e konferencës ndërstudentore “Impakti psikosocial dhe ekonomik i Covid 19”.

¹³⁷ Aneksi 4.03 Politikat e kërkimit shkencor.

¹³⁸ Aneksi 2.76. Relacion ëorkshop “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve”.

¹³⁹ Aneksi 2.81 Dokumentacion për përfshirjen e pedagogut Dr. Ida Kruti në standartizimin e testit MMPI-II.

¹⁴⁰ Aneksi 2.64 Axhenda dhe relacion i Konferencës “E ardhmja e Europës dhe kurrikula e studimeve, Kulturorë në biznes në kuadër të procesit të Bolonjës.

¹⁴¹ Aneksi 2.66 Axhenda e Konferencës “Intercultural studies in the field of justice, economic and social sciences”

	hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare për një shoqëri ende në zhvillim. Në këtë kuadër edhe ky program studimi, në të cilin janë angazhuar pedagogë ekspertë të fushës është fokusuar në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore kombëtare dhe rajonale. Pedagogët e këtij program studimi janë pjesë e angazhimeve akademike dhe më gjerë për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të politikave studimore e shkencore kombëtare dhe rajonale ^{142, 143} .			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë dhe strukturat e tjera ¹⁴⁴ janë partner në një sër projektesh si Erasmus +, përmes të cilit krijohen mundësi për shkëmbim të praktikave të mira në trajnime, leksione të hapura, mobilitete në mësimdhëne për stafin akademik dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. Gjithashtu institucioni mbështetet financiarisht stafin akademik ¹⁴⁵ përmes mështetjes për publikime shkencore në revista kombëtare dhe ndërkombëtar e pjesmarje në konferenca shkencore ¹⁴⁶ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të	Institucioni mbështet grupet lëndore përmes aktiviteteve ekstra - kurrikulare të realizuar në KU "Wisdom" si leksione të hapura ¹⁴⁷ , workshop ¹⁴⁸ , konferenca ¹⁴⁹ dhe projektet kërkimore shkencore të reja siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtar për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Përfshirja e stafit

¹⁴² Aneks 2.69. Relacion i workshopit "Përse bëjmë kërkim shkencor".

¹⁴³ Aneks 2.73. Relacion trajnimi CTB.

¹⁴⁴ Aneks 2.56. Relacion i përfshirjes së stafit në projekte.

¹⁴⁵ Aneks 4.06. Propozim dhe vendim për fondin e kërkimit shkencor.

¹⁴⁶ Aneks 2.67. Relacin mbi mbështetjen e personelit akademik.

¹⁴⁷ Aneks 2.74. Ftesa dhe relacioni Prof. Dr. Emilja Stoimenova Canevska.

¹⁴⁸ Aneks 2.76. Relacioni workshop "Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve".

¹⁴⁹ Aneksi 2.63. Axhenda dhe relacioni i Konferencës "A New Perspective for Universities in Europe. The Albanian Process 2020.

programit të studimit në kërkim shkencor.	akademik në këto projekte ka një impact pozitiv në drejtim të përmirësimit të kompetencave profesionale në drejtim të mësimdhënies dhe të avancimit në kërkim shkencor.			
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Përfshirja e stafit akademik dhe studentëve të njësisë bazë në një sër projektesh e studimesh me karakter kërkimor shkencor zhvillon dijet dhe kompetencat profesionale të tyre. Projektet ku kanë qenë partner anëtar të stafit akademik janë disa si: Shmangia e recedivizmit; Cultural studies in business; Fëmijë të sigurt dhe të shëndetshëm; Social inclusion through the multi-functional center in Përrenjas, Sadi Haliti"; Children card to strengthen children rights; Sporti si instrument integrimi për gratë, dance sportive -Të rinjtë e Tiranës në vendimmarrje nëpërmjet aplikacionit smart ¹⁵⁰ . Përfitimi i institucionit nga përfshirja në realizimin e këtyre projekteve shihet me përfitim në shumë plane dhe me impakt për studentët e stafin akademik.			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Një sër aktiviteteve ekstrakurrikulare janë organizuar nga KU "Wisdom". Ndër to mund të përfshijmë leksione të hapura me lektor të ftuar, të huaj e vendas, workshope, konferenca dhe takime informuese në lidhje me probleme të ndryshme psiko-sociale. Të gjitha këto aktivitete ndihmojnë njëzinë kryesore dhe bazë, stafin akademik dhe studentët në arritjen e objektivave të tyre formative dhe profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

¹⁵⁰ Aneks 2.56 Relacion mbi përfshirjen e stafit akademik në projekte.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies diktuar edhe nga kushtet e pandemisë, ku mësimi është zhvilluar online¹⁵¹. Aplikimi i metodave të ndryshme në lëndë e module mesimore, si studimet e rastit, analizat në grupe dhe individuale, detyrat e kursit dhe shkëmbimi i ideve, përdorimi i videove dhe artikujve ndihmojnë studentët të njihen me një mori formash interactive që lehtësojnë të kuptuarit e koncepteve teorike dhe përthyerjen e tyre në aspektin praktik e aplikative. Institucioni ka në funksion të përmirësimit të zhvillimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative kjo e nxitur se fundmi edhe nga kushtet e pandemisë globale. Platforma elektronike “Microsoft teams” i mundëson stafit akademik dhe studentëve të shkëmbejnë materiale dhe informacione në funksion të procesit mësimor. Ky informacion u mundësua nga burime dhe dokumente të ndryshme të vëna në dispozicion.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në drejtim të realizimit të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative për personelin akademik njësia bazë ka ngritur një strukturë të quajtur Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë¹⁵², i cili punën e tij e bazon në tre dokumenta që janë: Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë,¹⁵³ Sigurimi i cilësisë në nivel departamenti¹⁵⁴ dhe Strukturës për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë¹⁵⁵. Përmes tyre monitorohet puna e personelit akademik dhe ndihmës akademik në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Përfshirja e studentit në vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët, realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angzhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies¹⁵⁶. Administrimi i pyetësorit i lejon atyre ruajtjen e anonimatit gjatë dhënies së vlerësimit. Gjithashtu,</p>

¹⁵¹ Aneks 1.11. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit.

¹⁵² Aneks 2.15. Vendim për ngritja e NjSBC.

¹⁵³ ANEKS 1.06. Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

¹⁵⁴ Aneks 2.08. Vendim për ngritjen GVB.

¹⁵⁵ Aneks 1.09. Rregullore e komisionit për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Kurrikulës.

¹⁵⁶ Aneks 2.36. Model pyetësori i studentëve.

	edhe takimet në grupe me student e pedagogë ¹⁵⁷ , janë një tjetër formë që institucioni përdor në drejtim të përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të pedagogëve. ¹⁵⁸ .
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Vlerësimet periodike të ndërmarra nga institucioni pas zbardhjes së rezultateve i vihen në dispozicion njësisë bazë dhe asaj kryesore. Strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standarteve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, kanë ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. Së pari përmes planit të punës së NjSBC,¹⁵⁹ i cili lejon të mblidhet një informacion i detajuar mbi një sër aspektesh si vështrimi i përgjithshëm i gjendjes së programit të studimit, ndyshimet apo praktikën profesionale, plani i veprimit për vitin e ardhshëm, raportimi mbi veprimtaritë e ndërmarra, feedback-u i marrë nga studentët dhe stafi akademik në nivel programi, statistika të rregjistrimit të studentëve dhe të kalueshmërisë së tyre, burimet mbështetëse të programit të studimit, vlersimi i jashtëm, karriera dhe alumnit, profesionet e rregulluara si dhe praktikrat e mira nga institucionet e tjera. Ky vlersim kryhet nga grupi i sigurimit të cilësisë bazuar në rregulloren e saj¹⁶⁰ dhe monitoron programin në vijimësi, duke u siguruar informacione të rëndësishme si zyrës së sigurimit të cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë. Së dyti përmes takimeve të përbashkëta me pjesmarrjen e njësisive, stafit akademik dhe studentëve në lidhje me cilësinë e ofruar të shërbimeve të ofruara nga KU “Wisdom”. Prania e këtyre elementëve konsiderohen me ndikim pozitive në drejtim të mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me studentët.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Institucioni në drejtim të inkurajimit të personelit akademik në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie përveç mundësive për publikim në revistën “Wisdom”, pjesmarrjes pa pagesë të stafit akademik në konferencat e përbashkëta me institucionet e arsimit të lartë vendase dhe të huaja, lejon mobilitetin jashtë vendit nëpërmjet Erasmus +, përfshirjen në projekte kërkimore, aplikon në projekte kombëtare^{161, 162, 163}. Këto aspekte shihen si forma pozitive në drejtim të stimulimit dhe nxitjes së</p>

¹⁵⁷ Aneks 2.39. Relacion i pyetësorit të stafit akademik.

¹⁵⁸ Aneks 2.40. Relacion takimi i departamentit të psikologjisë me studentët.

¹⁵⁹ Aneks 2.35 Plan pune Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

¹⁶⁰ Aneks 1.06 Rregullore e Njësisisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë neni 15

¹⁶¹ Aneks 2.56. Relacion i përfshirjes së stafit në projekte.

¹⁶² Aneks 4.06. Propozim dhe vendim për fondin e kërkimit shkencor.

¹⁶³ Aneks 4.06. Propozim dhe vendim për fondin e kërkimit shkencor.

	personelit akademik për avancim në karrierën e tyre profesionale dhe në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga bisedat me stafin akademik, takimet me studentët dhe të tjerë aktorë, mësohet se sistemi i trasmetimit të dijeve bazohet kryesisht në leksionet dhe seminarët, kjo e mbështetur në formën interaktive të zhvillimit të njohurive, në funksion të një të kuptuari më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione. Këtyre dy formave të mësimdhënies e mësimnxënies u shtohen detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme, dhe provimet përfundimtare. Veprimtaritë e tjera ndihmëse¹⁶⁴ si leksionet e hapura me të ftuar të profilit të këtij programi studimit, konferencat shkencore gjithashtu janë në funksion të diversifikimit të formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies¹⁶⁵. Me ndikim pozitiv në këtë drejtim është dhe përdorimi i sistemit të teknologjisë së informacionit nga stafi dhe studentët në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i</p>	<p>Personeli akademik duket se ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me një literaturë të 5 viteve të fundit, gjithashtu liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Megjithatë implementimi i këtyre kërkesave duhet monitoruar në vijimësi me qëllim që program i studimit në "Psikologji Shkollore dhe Edukimi" në përgjithësi është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij dhe modulet e aktiviteteve formuese në veçanti,</p>

¹⁶⁴ Aneks 2.06. Plani strategjik për zhvillimin e programit.

¹⁶⁵ Aneks 4.07. Raporti i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

<p>hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Personeli akademik duket se ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me një literaturë të viteve të fundit, gjithashtu liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Mbështetur në raportin e vlersimit të brendshëm dhe në syllabuset e lëndëve mësimore.</p> <p><i>GVJ rekomandon një angazhim më të madh të strukturave të institucionit në drejtim të pasurimit të fondit të bibliotekës dhe gjithashtu të vet stafi akademik të angazhuar në këtë program studimi, për të përditësuar dhe pasuruar syllabuset e lëndëve me literaturë të viteve të fundit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Përsa i përket metodologjisë në mësimdhënie duke iu referuar syllabuseve, metodave të mësimdhënies sipas tematikave të ndryshme KU “Wisdom” përgjithësisht krijon kushte për një të nxënë efektiv, kjo evidentohet edhe nga diskutimi me studentët e stafin akademik. Ndërkohë nëse i referohemi syllabuseve të dërguara ku janë shënuar krahas të dhënave të tjera edhe titullari i lëndës dhe lektori që e zhvillon atë, kemi një përputhje midis Cv-ve të dërguar për stafin akademik i cili është angazhuar në këtë program studimi, listës emërore të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Master Shkencor në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” dhe profilit të tyre kualifikimit në fushën akademike dhe kërkimore. Përzgjedhja e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi është një element pozitiv për mësimdhënie cilësore dhe aftësi akademike në realizimin e lëndës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Vlerësimi i këtij kriteri mbështet në kërkesën e zyrës së kurrikulës dhe cilësisë për përditësimin e literaturës, ndërsa përsa i përket përfshirjes së studentëve në këtë proces ka një përpjekje përmes rolit të kordinatorit të programit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” dhe grupit të sigurimit të cilësisë në nivel departamenti si dy struktura që monitorojë kompetencat e personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie. Përfshirja e studentit në vlersimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe</p>

	<p>përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët¹⁶⁶, realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angazhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies. Administrimi i pyetësorit i lejon atyre ruajtjen e anonimatit gjatë dhënies së vlerësimit. Gjithashtu, edhe fokus grupet janë një tjetër formë që institucioni përdor në drejtim të përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të pedagogëve.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Nga vlerësimi i mënyrës sesi janë hartuar sylabuset ka larmishmëri përsa i përket formave të përdorura në mësimdhënie si role-play, studim rastesh, fokus-grupe që e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimi. Këto forma i përshtaten shumë mirë disiplinës së psikologjisë dhe ndihmojnë studentin të fitojë njohuri praktike mbi fushën e psikologjisë klinike. Gjithashtu, nga studentët për pedagogët pati në përgjithësi komente pozitive mbi formën e realizimit të leksionit por duke specifikuar se i referoheshin pedagogëve të profilit të psikologjisë klinike që u kishin dhënë mësim.</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Duke u mbështetur në informacionin e marrë nga takimi me studentët dhe pedagogët, por edhe nga rregulloret dhe udhëzimet e institucionit mbi rregullat e ndërtimit të marrëdhënies pedagog – student, respektohet dinjteti dhe integriteti i çdo studentit. Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies realizohet në një klimë pozitive dhe liria e mendimit respektohet duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë e të menduarit kritik të studentit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

¹⁶⁶Aneks 2.36. Model pyetësori i studentëve.

<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion infrastrukturën fizike¹⁶⁷ të nevojshme për realizimin e procesit mësimor në një godinë. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore ka në dispozicion një sipërfaqje të mjaftueshme, në salla leksioni dhe seminari me kapacitetin e nevojshëm për numrin e studentëve të këtij program studimi. Sallat e leksionit dhe të seminarit në dispozicion të procesit mësimor janë të pajisura me videoprojektor dhe kompjuter secila. Sallat janë të pastra dhe mirëmbahen nga stafi i agjencisë së kontraktuar për këtë shërbim.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Ambjentet në mbështetje të procesit mësimor janë brenda standardeve dhe janë funksionale, janë të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, si videoprojektor, sallat e leksionit janë të pajisura me foni dhe internet. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor një laborator informatike, bibliotekën online në Pro Quest¹⁶⁸ dhe Cobbis. net¹⁶⁹. Gjithashtu një ambient që është në shërbim të stafit dhe studentëve në lidhje me avancimin e tyre në drejtim të hulumtimit të literaturës për aspekte të ndryshme që lidhen me procesin mësimor është dhe biblioteka¹⁷⁰ e cila ka një kapacitet të mjaftueshëm për nevojat e studentëve të këtij programi profesional, me infrastrukturën e nevojshme si kompjuter dhe internet.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Institucioni ofron për stafin dhe studentët bibliotekat online duke u bazuar edhe në abonimin që ka në platformat online si Pro Quest dhe U-library-COBISS për qëllime të shfrytëzimit të literaturës për nevoja të stafit akademik dhe të studentëve. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor labore informatike, bibliotekën online. Sistemi “Microsoft Teams” i cili ka qenë një mjet kryesor i realizimit të procesit mësimor gjatë situatës së pandemisë globale, gjë që ka bërë të mundur që studenti të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive. Vërehet të ketë mundësi komunikimi nëpërmjet sistemit në komunikime të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, lejojnë studentin të jetë i informuar në kohë reale¹⁷¹. Ambientet janë të mbuluara me sinjal wifi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht në web. Pedagogët dhe studentët shprehen se shpesh i kanë konsultuar burimet e literaturës online për nevojat e tyre akademike.</p>

¹⁶⁷ Aneks 2.93 Kontrat qeraje.

¹⁶⁸ Aneks 2.53 Kontrat blerje Proquest.

¹⁶⁹ Aneks 2.52 Dokumenti i COBISS.

¹⁷⁰ Aneks 2.51. Relacion I bibliotekës së KU “Wisdom”.

¹⁷¹ Aneks 1.11. Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit.

	Duke qenë se ky program është i karkaterit shkencor, është e rëndësishmë të merret në konsideratë fakti që njohuritë e tyre në gjuhë të huaja lejojnë kuptimin e materialit në gjuhë të huaj.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.	<p>Literatura bazë në gjuhën shqipe¹⁷², e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi përfshin një literaturë e cila nëse i referohemi syllabuseve të lëndëve mësimore të vënë në dispozicion paraqesin një sër problemesh. Një pjesë e literaturës bazë është e një viti botimi e një dekade më parë dhe shkon ndesh me kërkesat ligjore për përditësim të literaturës mësimore me një literaturë të 5 viteve të fundit, i referohemi këtu literaturës së përdorur për disa lëndë¹⁷³. Një bazë me botime në formë teksti në hard-copy mund të aksesohet në bibliotekën e KU “Wisdom” duket e kufizuar në tituj dhe botime të psikologjisë që kryesisht përdoren si literaturë bazë në nivelin bachelor. Në një pjesë të lëndëve literatura e përkthyer në shqip dhe e përdorur për nevojat e zhvillimit të lëndëve mësimore është botimi i para 10 deri 15 viteve¹⁷⁴. Përsa i përket literaturës në formë elektronike në gjuhë të huaj mund të thuhet se është bërë një përpjekje pozitive përmes abonimit në bibliotekën online.</p> <p><i>Për sa më sipër <u>GVJ rekomandon</u>: përditësimin e literaturës me botime të 5 viteve të fundit; si dhe kujdes nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, në ruajtjen e një ekuilibri midis emërimit të lëndës mësimore apo modulit dhe literaturës së përdorur për realizimin e saj.</i></p>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Botimet në dispozicion të drejtimit kryesor të programit të studimit sipas të dhënave të bibliotekës dhe informacionit të shpërndarë nëpër dokumentet kemi një listë prej 200 tekstesh fizike, nga të cilat 1200 tituj janë në format pdf në gjuhën angleze. Bazuar në blerjen e 38 titujve për bibliotekën për vitin akademi 2020-2021, prej të cilave pjesa më e madhe e tyre kanë një vit botimi para 2010 ¹⁷⁵ . Një pjesë e vogël e teksteve janë në gjuhë të huaj kryesisht botime të viteve 2001-2010. Megjithatë pranë bibliotekës kishte një numër të konsiderueshëm tekstesh online në fushën e psikologjisë, të cilat mund të përdoren nga stafi dhe studentët, por këtij aspekti i shërben edhe biblioteka online Proquest dhe Cobiss. Nett.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies,	Personeli akademik dhe studentët kanë në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies platformën elektronike të

¹⁷² Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

¹⁷³ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

¹⁷⁴ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

¹⁷⁵ Aneks 2.55. Propozim dhe vendim për blerjen e titujve.

<p>personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>aksesimit në bibliotekën online të Proquest, gjithashtu mund të thuhet se fondi i bibliotekës së institucionit kishte tekste në formë elektronike të fushës së psikologjisë në gjuhë të huaj që viheshin në dispozicion të stafit dhe studentëve të programit të studimit. Nuk u pa ndonjë abonim në revista të fushës së psikologjisë shkollore dhe edukimit në bibliotekë. Biblioteka e KU “Wisdom” ishte pjesë e sistemit COBISS Net (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online), ku janë të përfshira vendet e rajonit të Europës Juglindore.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Infrastruktura në mbështetje të zhvillimit të detyrave të ndryshme nga studenti ishte e përshtatshme dhe të lejonte akses në një sër formash ndërveprimi, si mbulimi i ambjenteve të KU “Wisdom” me Wi-Fi, biblioteka e pajisur me sallë leximi dhe hapësira komode për të punuar me literaturën, kompjuter në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë literaturën on-line të vëna në dispozicion përmes shfrytëzimit të platformave online Cobiss dhe Proquest.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Institucioni ofron për stafin dhe studentët bibliotekat online duke u bazuar edhe në abonimin që ka në platformat online si Proquest, dhe U-library-COBISS për qëllime të shfrytëzimit të literaturës për nevoja të stafit akademik dhe të studentëve¹⁷⁶. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor laboratore informatike, bibliotekën online. Sistemi “Microsoft Teams” i cili ka qenë një mjet kryesor i realizimit të procesit mësimor gjatë situatë së pandemisë globale ka bërë të mundur që studenti të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive. Vërehet të ketë mundësi komunikimi nëpërmjet sistemit në komunikime të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, lejojnë studentin të jetë i informuar në kohë reale. Ambjentet janë të mbuluara me sinjal wifi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht web. Pedagogët dhe studentët shprehen se shpesh i kanë konsultuar burimet e literaturës online për nevojat e tyre akademike.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Sistemi komunikimi i brendshëm realizohet nëpërmjet domain-it zyrtar të KU “Wisdom” emer.mbiemer@wisdom.edu.al dhe “Microsoft Teams” i cili ka qenë një mjet kryesor i realizimit të procesit mësimor gjatë situatës së pandemisë globale ka bërë të mundur që studenti të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive. Vërehet të ketë mundësi komunikimi nëpërmjet sistemit në komunikime të hapura</p>

¹⁷⁶ Aneks 2.51. Relacion I bibliotekës së KU “Wisdom”.

	<p>me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, lejojnë studentin të jetë i informuar në kohë reale. Ambjentet janë të mbuluara me sinjal wfi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht web. Pedagogët dhe studentët shprehen se shpesh i kanë konsultuar burimet e literaturës online për nevojat e tyre akademike. Përsa i përket përdorimit të hapësirës vetjake dedikuar stafit dhe studentëve mund t'i refrohemi sistemit "Microsoft Teams", ku secili prej përdoruesve regjistrohet dhe në vijim akseson në sistem në çdo kohë dhe vend duke u informuar në lidhje me procesin mësimor, sezonin e provimeve, pikët e grumbulluara në lëndë e module të ndryshme etj. Ky sistem i brendshëm komunikimi shihet si tepër efektiv në drejtim të rrijës së aksesit në burimet e brendshme të informacionit si nga ana e stafit dhe e studentëve por edhe si forma kryesore e realizimit të procesit mësimor në nivel global në institucionet e arsimit të lartë si pasojë e COVID-19.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave të vëna në dispozicion nga institucioni në lidhje me orientimin, asistimin dhe mbështetjen nga ana e personelit akademik për studentët gjatë fazës së diplomimit¹⁷⁷ KU "Wisdom" ka një strukturë të mirë organizuar, e cila i krijon kushtet e nevojshme studentit në përmbylljen me sukses të kësaj faze. Kjo realizohet konkretisht nga njësia bazë dhe kordinatori i programit të studimit, i cili paraqet studentëve listën e pedagogëve që janë në dispozicion për programin e studimit, më pas student plotëson formularin e aplikimit për temën e diplomës, departamenti bën miratimin e tyre sipas kriterëve specifike për punimin e temës duke u bazuar në udhëzuesin e saj, gjithashtu të detyrueshme për studentin takimet me udhëheqësin e tij.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.4</p>	
<p>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

¹⁷⁷ Aneks 3.05 Rregullore e diplomimit.

<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni ka ngritur disa struktura, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie, përmes Zyrës së Kordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, Komisionit të Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë, Kordinatorit të programit të studimit, Zyrës së kurrikulës. Puna e këtyre strukturave synon monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standartet shtetërore dhe ato ndërkombëtare. Strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimit të cilësisë dhe respektimin e standarteve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, kanë ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. Së pari përmes raportit vjetor të programit të studimit i cili lejon të mbledhi një informacion të detajuar mbi një sër aspektesh si vështrimi i përgjithshëm i gjendjes së programit të studimit, ndyshimet apo praktikën profesionale, plani i veprimit për vitin e ardhshëm, raportimi mbi veprimtaritë e ndërmarrë, feedback-u i marrë nga studentët dhe stafi akademik në nivel programi, statistika të rregjistrimit të studentëve dhe të kalueshmërisë së tyre, burimet mbështetëse të programit të studimit, vlersimi i jashtëm, karriera dhe alumnit, profesionet e rregulluara si dhe praktikat e mira nga institucionet e tjera. Ky vlersim kryhet nga grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti monitoron programin në vijimësi, duke u siguruar informacione të rëndësishme si zyrës së sigurimit të cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë¹⁷⁸. Së dyti përmes takimeve në grupe të organizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë ka ndërmarrë takime me studentët e programit të studimit në lidhje me cilësinë e ofruar të shërbimeve të ofruara nga KU “Wisdom”¹⁷⁹. Prania e këtyre elementëve konsiderohen me ndikim pozitive në drejtim të mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me studentët.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia kryesore dhe ajo bazë në bashkëpunim me zyrën e sigurimit të cilësisë ka ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. Mjetet si raportit vjetor i të programit të studimit i cili lejon të mbledh një informacion të detajuar mbi një sër aspektesh të rëndësishme¹⁸⁰. Si dhe grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti i cili monitoron programin në vijimësi, duhe u siguruar informacione të rëndësishme si zyrës së sigurimit të</p>

¹⁷⁸ Aneks 2.12. Analiza vjetore e departamentit të psikologjisë 2019-2020.

¹⁷⁹ Aneks 2.40. Relacion takimi I departamentit të psikologjisë me studentët.

¹⁸⁰ Aneks 2.12 Analizë vjetore e Departamentit të Psikologjisë 2019- 2020.

	cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Strukturat dhe njësia bazë duket se inkurajojnë format e reja dhe inovative në mësimdhënie përmes hapësirave në drejtim të organizimit të leksioneve të hapura me lektorë të ftuar vendas dhe të huaj ¹⁸¹ . Institucioni duket se bën përpjekje në këtë drejtim përmes kërkesës për përditësim të literaturës për lëndët përkatëse dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor ¹⁸² përmes krijimit të mundësisë për publikim në revistën “Wisdom” dhe shfrytëzimit të bibliotekës online.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe të trajnimit të stafit akademik janë realizuar disa aktivitete me profesorë të ftuar të huaj dhe vendas ¹⁸³ . Ndër to mund të evidentojmë trajnime e workshope, konferenca dhe mobilitete të stafit akademik me mbështetjen e programit ERASMUS+. Po ashtu vlen të theksohen si të përshtatshme edhe një sër aktiviteteve si tryeza e rrubullakët mbi organizim leksioni të hapur me lektor të ftuar. Përmes krijimit të mundësisë për publikim në revistën “Wisdom” dhe pjesëmarrjes në konferencat që KU “Wisdom” organizon pa pagesë për stafin e tij akademik ¹⁸⁴ , gjithashtu synon të mbështetet ky aspekt nga institucioni ¹⁸⁵ .
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	KU “Wisdom” duke u mbështetur në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie ka realizuar një sër aktiviteteve që kishin në fokus trajnimin e stafit në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i sigurojnë trajnim të vazhdueshëm për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja duke ftuar trajnues/lektorë vendas dhe të huaj ¹⁸⁶ . Në këto programe trajnimi është përfshirë personeli akademik efektiv, duke realizuar/drejtuar procesin trajnues, ose leksionet e hapura. Personeli ndihmës akademik është i angazhuar në implementimin e metodave të reja duke frekuentuar takimet dhe workshop-et e organizuara si workshopi dy ditor me lektorë të huaj të ftuar PhD. Ronald M. Nate, me temë: “An Economics Professor’s Approach to Teaching a Difficult Subject”. ¹⁸⁷

¹⁸¹ [Aneks 1.03 Plani Strategjik i Kolegjit Universitar “Wisdom”.

¹⁸² Aneks 4.07 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

¹⁸³ Aneks 4.04 Analizë vjetore e Njësisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

¹⁸⁴ Aneks 4.08 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik.

¹⁸⁵ Aneks 4.07 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

¹⁸⁶ Aneks 4.07 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

¹⁸⁷ Aneks 2.70 Axhenda e ëorkshoptit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M.Nate.

<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli i angazhuar në këtë program studimi përmirësohet vazhdimisht, kjo lidhur me kualifikimin dhe fushën e ekspertizës së zotëruar dhe përputhjes me lëndët apo modulet që mbulojnë, duke e vënë theksin jo vetëm te vijimësia në tre cikle studimi brenda fushës, por edhe në kualifikime të tjera profesionale që përkojnë me lëndën që mbulojnë. Stafii akademik monitorohet në punën e tij periodikisht përmes të dhënave të raportuara në formularin e vlerësimit të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike e kërkimore-shkencore pranë Njesisë së Kërkimit Shkencore dhe Marrëdhënieve me Jashtë.¹⁸⁸.</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Në lidhje më këtë kriter nuk kemi evidence të qartë përse i përket testimit dhe analizës nga ana e stafit mbi metodat e reja në mësimdhënie. Por vërtetohet se ka procedura që ndiqen nga institucioni mbi monitorimin e procesit të mësimdhënies përmes formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti, dhe formulari i vlerësimit të performancës, procedura që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie.</p> <p><i>Sugjerohet nga GVJ, një punë më e mirë nga njësia bazë në drejtim të monitorimit me kujdes të syllabuseve të lëndëve që miraton, pasi ky aspekt duke iu referuar syllabuseve të lëndëve paraqet probleme të dukshme.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Njësia kryesore/bazë duke u mbështetur në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie ka realizuar një sër aktivitetesh që kishin në fokus trajnimin e stafit, duke u siguruar trajnim të vazhdueshëm për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja duke ftuar trajnues/lektorë vendas dhe të huaj¹⁸⁹. Në këto programe trajnimi është përfshirë personeli akademik efektiv, duke realizuar/drejtuar procesin trajnues, ose leksionet e hapura. Personeli ndihmës akademik është i angazhuar në implementimin e metodave të reja duke frekuentuar takimet dhe workshop-et e organizuara si workshopi dy ditor me lektorë të huaj të ftuar PhD. Ronald M. Nate, me temë: “An Economics Professor’s Approach to Teaching a Difficult Subject”¹⁹⁰</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

¹⁸⁸ Aneks 4.05 Formulari i vlerësimit të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike e kërkimore-shkencore.

¹⁸⁹ Aneks 4.07 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

¹⁹⁰ Aneks 2.70 Axhenda e ëorkshoptit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M.Nate.

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive shkencore e profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit të studimit, sistemin e vlersimit të studentit, formatin e punimit të diplomës. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive¹⁹¹ bëhen publike dhe njihen nga studentët në kohë reale edhe duke shfrytëzuar sistemin Microsoft Teams, platforma elektronike që përdoren nga studentët e këtij program studimi. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive¹⁹² bëhen publike dhe njihen nga studentët edhe përmes sekretarisë mësimore dhe vetë pedagogut të lëndës në fillim të çdo semestri¹⁹³. Kjo procedurë respektohet nga stafi akademik dhe studentët informohen në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në silabuset e lëndëve/moduleve, në orët e para, si dhe ky informacion i jepet studentit në departamentin e psikologjisë.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në hartimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” në fillim të çdo semestri nga titullari i lëndës bëhet njohja me të gjitha aspektet që përfshijnë studentët. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme¹⁹⁴,¹⁹⁵ dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësimi më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlersimin e performancës akademike të studentit.</p>

¹⁹¹ Aneksi 2.41 Model testi i pjesshëm.

¹⁹² Aneks 2.42. Model testi përfundimtar.

¹⁹³ Aneksi 3.10. Komisionet e sezonit të dimrit 2020-2021.

¹⁹⁴ Aneksi 2.41 Model testi i pjesshëm.

¹⁹⁵ Aneks 2.42. Model testi përfundimtar.

<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Studentit i jepen hapësirat e nevojshme për të demonstruar përvetësimin e njohurive përmes vlerësimit nga detyrat e kursit, mendimet dhe reflektimet personale të shpalosura në auditor, formës së hartimit të testit të ndërmjetëm dhe final me diversitet pyetjesh dhe formash të nxitjes së të nxënit. Duke i dhënë në këtë mënyrë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në varësi të stilit personal të të nxënit. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim ose me gojë. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma, për programin e studimit. Nuk kemi evidenca për realizimin e testimit përmes sistemit elektronik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Mbështetur në procedurën e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit¹⁹⁶, vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlerësimin e performancës akademike të studentit. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim ose me gojë. Llojet e provimeve që zhvillohen për</p>

¹⁹⁶ Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në "Psikologji Shkollore dhe Edukimi.

	kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm ¹⁹⁷ , Provimi përfundimtar ¹⁹⁸ , Riprovimi, Përmirësimi, Diploma për programin e studimit ¹⁹⁹ .
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit përmes sekretimit të provimeve dhe në kushtet e Pandemisë pjesa më e madhe e tyre realizohen në platformat elektronike “Microsoft Teams”. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma për programin e studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”. Përmes Portalit të Studentit http://portal.hstalb.xyz/ si dhe platformës Microsoft Teams ofron opsionin e testimit dhe vlerësimit online me qëllimin që të eliminojë mundësitë dhe format e abuzimit, si dhe të rrisë transparencën për një testim dhe vlerësim.
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Njësia bazë ka një procedurë të mirëorganizuar ²⁰⁰ në drejtim të hapave e afateve kohore që ndjek në drejtim të miratimit, dhe kohës së përgatitjes së tezës së provimit nga pedagogu i lëndës ²⁰¹ , ²⁰² . Disa prej këtyre aspekteve kanë të bëjnë me; dorëzimin të paktën një ditë përpara zhvillimit të provimit për t'u miratuar nga Përgjegjësi i njësisë bazë, kur numri i studentëve në sallën e provimit e tejkalon 50% të kapacitetit të saj, pedagogu duhet të përdorë dy teza të ndryshme. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për zhvillimin e provimit, por ai shoqërohet nga një anëtar i stafit akademik ²⁰³ . Praktikat profesionale, dhe mbrojtja e diplomave realizohen me komision prej dy ose më shumë anëtarësh.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë	Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim nga ana e personelit ndihmës akademik të departamentit që bën sekretimin e tezave ²⁰⁴ . Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të monitoruesve të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur

¹⁹⁷ Aneks 2.41 Model testi i ndërmjetëm.

¹⁹⁸ Aneks 2.42 Model testi përfundimtar.

¹⁹⁹ Aneks 3.05 Rregullore e diplomimit.

²⁰⁰ Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar “Wisdom”.

²⁰¹ Aneks 2.07 Rregullore e Departamentit të Psikologjisë.

²⁰² Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”.

²⁰³ Aneks 3.10 Komisionet e sezonit të dimrit 2020-2021.

²⁰⁴ Aneks 1.07 Rregullore e Sekretarisë Mësimore.

të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	anonimatin e çdo studenti. Çsekretimi i tezave të korigjuara të provimit dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, e cila bën çsekretimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student. Nuk kemi evidenca për përdorimin e mjeteve të tjera të survejimit të provimit me qëllim që të shmangen abuzimet ²⁰⁵ .
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në lidhje me komentet apo feedback-un mbi rezultatet e testimit nuk kemi evidenca për të gjykuar plotësisht mbi këtë aspekt, por ka procedurë të mirëorganizuar për mënyrën, sesi hartohet teza dhe realizimi i vlerësimit në mënyrë të copëzuar që t'u japë mundësi studentëve që iu përshtaten stileve të ndryshme të të nxënës ²⁰⁶ . Pedagogu i lëndës pas provimit dorëzon në departament tezën origjinale dhe çelësin e zgjidhjes së tezës, të cilat mund t'i vihen në dispozicion studentit, nëse dëshiron të qartësohet.
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Respektimi i procedurave dhe realizimi me korrektësi nga stafi akademik synojnë që përmes rregullave ²⁰⁷ , ²⁰⁸ që lidhen me kushtet si mospërdorimi i së njëjtës tezë provimi për grupe që e zhvillojnë provimin në orare të ndryshme, dhe as përsëritja e së njëjtës tezë brenda të njëjtit vit akademik (përfshirë sezonin e riprovimit) japin mundësi të mira për të shmatur plagjiaturën dhe kopjimin në provime dhe detyra. Drejtuesi i Departamentit garanton zbatimin e këtij rregulli.
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Institucioni disponon një procedurë të mirëfilltë për të përkjet gjithë procesit që lidhet me procedurat e provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimimit nga ana e studentit. Procedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat sipas përcaktimeve përkatëse sesi bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij procesi të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit ²⁰⁹ dhe në syllabusin e lëndës ²¹⁰ .
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni respekton procedurat e njohjes me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlersimit. Këto procedura janë konform legjisllacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit ²¹¹ . Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin brenda 15 ditësh, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Komunikimi i

²⁰⁵ Aneks 2.07 Rregullore e Departamentit të Psikologjisë.

²⁰⁶ Aneks 2.45 Model relacioni semestral.

²⁰⁷ Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar "Wisdom".

²⁰⁸ Aneks 2.07 Rregullore e Departamentit të Psikologjisë.

²⁰⁹ Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në "Psikologji Shkollëre dhe Edukimi".

²¹⁰ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

²¹¹ Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në "Psikologji Shkollëre dhe Edukimi".

	vlerësimeve bëhet në respektim të plotë të privatësisë së studentit. Studenti njihet me rezultatet në portalin e studentit. https://portal.hstalb.xyz/ .			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	Duke u bazuar te rregullorja e KU “Wisdom” ²¹² , por edhe te rregullorja e programit dhe dokumenti mbi sistemin e vlerësimit të studentëve ekziston një procedurë, e cila i jep mundësi studentëve të ndjekin këtë proces në mënyrë korrekte. Rivlerësimi i testimit bëhet nga një komision i posaçëm konform rregullave ligjore dhe në mbështetje të të drejtave të studentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk është përmbushur	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” i jep mundësi studentëve të zgjerojnë njohuritë në një gamë të gjerë të profileve interdisiplinare në kontekstin e fushës së psikologjisë shkollore dhe të edukimit, por kjo larmishmëri mund të shihet edhe si jo e plotë nëse lëndët mësimore bazohen në një literaturë të përsëritur²¹³ të atyre njohurive që studentët i kanë marrë në ciklin e parë të studimeve, nëse literatura nuk përditësohet me një literaturë të pesë viteve të fundit. Në drejtim të thellimit të njohurive për aspektet më të imta që lidhen me fushën e psikologut shkollor/edukim dhe në një aftësim për të zhvilluar kompetenca profesionale tek studentët, lidhur me profilin e psikologut shkollor.</p> <p><i>Grupi i vlersimit të jashtëm rekomandon që stafi të realizojë një përditësim të njohurive akademike mbi zhvillimet e fundit në këtë fushë, të cilat gjithashtu edhe duhet të shpалosen në syllabusin e lëndëve.</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të	Institucioni dhe ky program studimi synojnë krijimin e kushteve që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së

²¹² Aneksi 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar “Wisdom”.

²¹³ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

<p>veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>informacionit në aspektin praktik përmes trajnimit të studentit për të përdorur sistemin “Microsoft Teams” dhe sitemin online të shfrytëzimit të literaturës në bibliotekat online. Në drejtim të komunikimit dhe ndërveprimit kemi një sër aktivitetesh që ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim si angazhimi i stafit bashkë me studentët në qendrën e këshillimit psikologjik dhe aktivitetet ekstra kurrikulare ku janë përfshire studentët si veprimtari bamirësie, konferenca dhe leksione të hapura që u japin mundësi ndërveprimi.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Në këtë drejtim kemi nismën e njësisë bazë, e cila realizon në mënyrë periodike analizën e punës, ku kërkon në fund të semestrit nga pedagogu i çdo lënde apo moduli një analizë të punës në lidhje me objektivat e arritura të lëndës si dhe rekomandimet në lidhje me të ardhmen²¹⁴. Prezenca e këtyre praktikave në institucion shihet si element pozitiv në drejtim të përpjekjeve për të ofruar lëndë e module që synojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësitë e studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në lidhje me aplikimin e këtij standarti kemi evidenca për të nxjerr konkluzione dhe diskutimin e orientuar të studentëve para provimeve nga secili prej personelit akademik që është angazhuar në këtë program studimi. Pedagogu i çdo lëndë në fund të semestrit para provimit përfundimtar realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në këtë drejtim institucioni ka praktika të mira përsa i përket hapësirave që ka stafi akademik për të përfituar nga evente të ndryshme, të cilat realizohen përgjatë vitit akademik, si konferenca, simpoziume, leksione të hapura me të ftuar dhe personalitete të larta të vendit dhe të huaj, veprimtari promovuese. Personeli akademik dhe studentët janë të angazhuar në pjesëmarrjen në këto veprimtari²¹⁵. Po ashtu vlen të theksohen si të përshtatshme edhe një sër aktivitetesh si tryeza e rrubullakët mbi organizimin orëve të hapura me lektor të ftuar në platformën elektronike “Microsoft Teams”, kjo e fundit i përgjigjet më së miri edhe nevojave aktuale të institucioneve të arsimit të lartë si përgjigje ndaj situatës së pandemisë globale. Përmes krijimit të mundësisë për publikim në revistën “Wisdom”, revista ndërkombëtare dhe pjesmarrjes në</p>

²¹⁴ Aneks 2.45 Model relacioni semestral.

²¹⁵ Aneks 2.82 Axhenda dhe relacion i javës dialektike.



	konferencat që KU "Wisdom" organizon pa pagesë për stafin e tij akademik krijohen mundësi të tjera në këtë drejtim.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	<p>Përsa i përket mundësisë për zhvillimin e mësimdhënies mbi bazë kompetencash ka evidenca që na ndihmojnë të gjykojmë mbi këtë aspekt. Disa module të lëndëve karakterizuese jo vetëm kërkojnë njohuri të thelluara teorike të marra përmes kualifikimit akademik, por gjithashtu njohuri dhe kompetenca praktike që janë zhvilluar përmes përvojës praktike të fituar drejtpërdrejtë në fushë të cilat përmes diskutimit të studimeve të rasteve të sjella nga vetë pedagogu zhvillojnë kompetencat profesionale të studentëve. Gjithsesi, vlerësohet që ka problematika që ndikojnë negativisht në këtë aspekt si literature e vjetëruar²¹⁶, të cilat nuk janë përditësuar me literaturë të 5 viteve të fundit, dhe përsëritja e literaturës bazë në lëndë të caktuara mësimore.</p> <p><i>GVJ sugjeron kapërcimin e saj nëse stafi akademik angazhohet në një proces përmirësimi të literaturës së përdorur për nevojat e lëndës mësimore dhe në përputhje me emërtimin e saj.</i></p>
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.	Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të caktuara në kontekstin shkollor. Duke u bazuar në mënyrën e ndërtimit të silabuseve të lëndëve/modulev ²¹⁷ e por edhe nga takimet e realizuara me stafin akademik dhe studentët, duket se përmbushet plotësisht. Pasi mësimdhënia bazohet në diskutimet e ndryshme, studimet e rasteve, nxitjen e mendimin kritik mbi çështjet që trajtohen duke e vendosur studentin në një pozicion aktiv në drejtim të përvetësimit të dijeve dhe të nxëniet në tërësi.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Ky element duhet parë në vijimësi, pasi personeli akademik në pjesën më të madhe referuar syllabuseve të lëndëve mësimore, mënyra sesi do implemetojë në planin mësimor të lëndës idetë inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore në mbështetje të nevojave të studentit në lidhje me avancimin në njohuri mund të bëhet e arritshme. Kjo duke iu referuar përvojës profesionale të një pjese të stafit mund të jetë mëse e mundur, por programi i lëndës dhe literatura e përdorur nga personeli akademik te një pjesë e lëndëve mësimore në drejtim të procesit të mësimdhënies duhet të përmirësohet.

²¹⁶ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

²¹⁷ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

	<i>Bazuar në këto problematika të evidentuara <u>GVJ</u> rekomandon një angazhim më të madh nga strukturat përgjegjëse të njësisë bazë, në monitorimin dhe miratimin e syllabuse të lëndëve mësimore pasi në këtë mënyrë rrezikohet që lëndë të ndryshme të përsërisin njohuritë që japin në auditor.</i>			
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Bazuar në përfshirjen në projekte apo përfshirjen në botime të artikujve dhe punëve shkencore në bashkëpunim me pedagogët, apo bashkëpunimi për konferenca kemi disa evidenca lidhur me organizimin e konferencës studentore, e cila është e përvitshme. Në këtë konferencë, studentët duke bashkëpunuar me pedagogët e tyre paraqesin punimet e tyre kërkimore. Gjithashtu institucioni disponon dokumentacion në lidhje me akordimin e një fondi vjetor Këshillit Studentor si mbështetje për aktivitetet dhe implementimin e ideve inovative ²¹⁸ .			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	Përsa i përket bashkëpunimit në drejtim të mësimdhënies me instiucionet e tjera kemi nisma me një sër institucionesh brenda dhe jasht vendit të organizuara nga KU "Wisdom" si konferenca, workshop-e, leksione të hapura, trajnime të stafit lidhur me rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu një veprimtari e vlefshme është ajo me Erasmus + KA107 për realizimin e mobiliteti i stafit dhe studentëve të këtij program shihet si pozitiv, por është herët për të vlerësuar vijimësinë e tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e	Bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit Msc në "Psikologji Shkollorë dhe Edukimi" ²¹⁹ dhe mbi manualin e punimit të temës së diplomës, ²²⁰ institucioni ka hartuar procedurë të posaçme për studentët, të cilët mbrojnë diplomën. Kriteret për mbrojtje diplome me

²¹⁸ Aneks 2.85 Vendim i Administratores për Fondin e Këshillit Studentor.

²¹⁹ Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në "Psikologji Shkollorë dhe Edukimi".

²²⁰ Aneks 3.05 Rregullore e diplomimit.

<p>diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>temë për këtë program studimi bëhen të ditura përmes kordinatorit të programit. Njësia bazë ka një format të posaçëm për realizimin e reçencës dhe oponencës për çdo student.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të mbrojtjes së diplomës²²¹. Përsa i përket realizimit të temës së diplomës studentët e këtij programi në përfundim të këtij cikli studimi, diplomohen si kërkues shkencor në profilin e psikologjisë shkollore dhe të edukimit pas mbrojtjes së diplomës. Mbrojtja e diplomës me temë ka një procedurë që e lehtëson punën e studentit në drejtim të përzgjedhjes së pedagogut udhëheqës sipas profilit të temës dhe monitorimin e punës përmes seancave të konsultimit që janë të detyrueshme nga studentit për t'u ndjekur përgjatë gjithë procesit²²². Monitorimin e zbatimit të këtyre procedurave e realizon njësia bazë.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha njohuritë e fituara në lëndët/ modulet të nevojshme për realizimin e projektit të tyre kërkimorë që të fitojnë gradën kërkues shkencor në psikologji shkollore dhe edukimi. Realizimi i një punimi shkencor nga studentët i jep mundësi komisionit të bëjë një vlerësim të kompetencave kërkimore dhe profesionale të përvetësuar nga studentët përgjatë këtij itinerari formavit 2 vjeçar. Bazuar në rregulloren e programit të studimit studentët vihen në dijeni në fillim të semestrit të dytë, të vitit të dytë, nga Përgjegjësi i Departamentit mbi rregulloren e mbrojtjes së punimit të diplomës, që kërkon vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore, si dhe të kenë qënë të suksesshëm në realizimin e praktikës profesionale, të plotësojnë kriterin e gjuhës së huaj si dhe të kenë shlyer detyrimet ndaj institucionit.²²³.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temës së diplomës. Përsa i përket përgatitjes së temës së diplomës kemi një procedurë formale të përcaktuar nga rregullorja e programit të studimit dhe monitoruar nga njësia bazë, e cila detyron studentin dhe pedagogun në realizimin e seancave të konsultimit individuale përgjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit, si dhe të nënshkrimit</p>

²²¹ Aneks 3.05 Rregullore e diplomimit.

²²² Aneks 3.05 Rregullore e diplomimit.

²²³ Aneks 3.01 Rregullore e programit të studimit "Master i Shkencave" në "Psikologji Shkollore dhe Edukimi".

	nga pedagogu udhëheqës të punimit final para se të dorëzohet tek komisioni i mbrojtjes.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në drejtim të krijimit të mundësive për realizimin e punëve kërkimore nga ana e studentëve jasht institucionit, ai ka nënshkruar një sër marrëveshjesh bashkëpunimi. Megjithatë kemi pak evidenca që na lejojnë të arrijmë në përfundime në lidhje me asistimin e ofruar nga institucioni në terma faktik. Përsa i përket asistimit brenda kemi një sërë lehtësirash që e ndihmojnë studentin, si seancat e konsultave individuale, konsultat me pedagogët, aksesit në bibliotekat online, mjedisi i brendshëm i mbuluar me wi-fi, biblioteka dhe salla e leximit.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i diplomës përmes seancave të konsultimit individual i ofron mundësi studentit të ndjekë kriteret në përcaktimin e metodave kërkimore që i lejojnë të mbledh, të administrojë dhe përpunojë të dhënat në mënyrë shkencore. Roli i udhëheqësit fokusohet në mbështetjen dhe ndihmën e studentit që të njoh dhe respektojë kriteret për realizimin e një punimi shkencor origjinal. <i><u>GVJ rekomandon për institucionin, instalimi i një sistemi që i lejon institucionit të monitorojë pandershmërinë dhe lufton plagjiaturën do e lehtësonte mjaft këtë proces.</u></i>
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Bazuar në rregulloren e institucionit dhe rregulloren e brendshme të programit të studimit vlerësimi i studentëve në përfundim të provimit të përgjithshëm dhe punimit të diplomës realizohet para komisionit të diplomimit dhe vlerësohet me notë nga ky komision.
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Programi i studimit të ciklit të dytë Msc. Në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” është konform ligjeve dhe procededurave të Q.SH.A.– së për miratimin e Suplementit të diplomës dhe aneksin e listës së notave. Forma e paraqitjes së diplomës është konform profilit dhe njohurive të fituara përgjatë këtij rrugëtimi profesional të studentëve. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën ²²⁴ , listë notash ²²⁵ dhe suplementin e diplomës ²²⁶ në programin e studimit “Master Shkencor” në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”. Kjo formë e paraqitjes së diplomës është konform dokumentacionit që shoqëron këtë rrugëtim profesional të studentëve. Ky kualifikim emërtohet në të njëjtën formë si në modelin e diplomës dhe në listën e notave e suplementin e diplomës dhe janë të unifikuara dhe me emërtimin, me të cilin programi ka marrë vendimin për organizim të

²²⁴Aneks 3.08 Modeli i diplomës.

²²⁵Aneks 3.09 Modeli i Suplementit të Diplomës.

²²⁶Aneks 3.08 Modeli i diplomës.

	tij nga MASR. Ky program studimi synon ndërthurjen midis kompetencave kërkimore e profesionale të studentit dhe pajisjen me diplomë shkencore referuar nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. ²²⁷ .								
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve një kopje zyrtare të silabuseve të këtij programi studimi në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të vetë studentit. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).								
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe pajisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat ²²⁸ . Nga takimi me aktorët përkatës mësohet se institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve ²²⁹ , dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

²²⁷Nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. <http://www.akafp.gov.al/ep-content/uploads/2014/09/NIVLELET-E-KORNIZ%C3%8BS-SHOIPTARE-T%C3%8B-KUALIFIKIMEVE.pdf> (Aksesuar më datë 07-01-2021).

²²⁸ Aneks 2.34 Rregullore e Arkivës.

²²⁹ Aneks 1.07 Rregullore e Sekretarisë Mësimore.

Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e burimeve njerëzore²³⁰ është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në këtë program studimi. Stafi akademik dhe ndihmës kanë dosjet personale me të dhëna të plota. Kjo zyrë merret me procedurat e rekrutimit të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe me stafin ndihmës akademik. Kjo zyrë mban evidenca për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka një procedurë rekrutimi për personelin akademik përmes disa hapash që fillon me shpalljen e thirrjes online, përgatitjen e short listave për komisionin e rekrutimit, i cili merr vendimin në bazë të kriterve të përcaktuara nga baza ligjore në fuqi mbi rregullat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik²³¹, Ligjin Nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligji për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, Ligji Nr.9887 dt.10.03.2008 ndryshuar me ligjin Nr.48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Procedurat e përcaktuara nga institucioni në lidhje me afatet, kriteret e përgjithshme dhe specifike për tu bërë pjesë e stafit akademik të KU “Wisdom”, janë konform rregullores për burimet njerëzore dhe rregullores së institucionit, dhe në linjë me udhëzimet dhe legjislacionin për arsimin e lartë në vend. Kriteret shpallen publikisht në faqen online të KU “Wisdom” dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Institucioni në fillim të vitit akademik publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik²³². Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti konform ligjit për arsimin e lartë dhe udhëzimeve të tjera në fuqi. Kriteret e rekrutimit</p>

²³⁰ Aneks 1.08 Rregullore e Zyrës së Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore.

²³¹ Aneks 2.24 Politikat e rekrutimit.

²³² Aneks 2.25 Procedurat e rekrutimit.

	të personelit akademik publikohen në faqen zyrtare web www.wisdom.edu.al të KU "Wisdom", pas identifikimit të nevojave.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Institucioni ndjek procedura rekrutimi korrekte të shpalljeve publike përmes mjeteve të komunikimit që insitucioni ka në dispozicion, si faqja e universitetit dhe rrjetet sociale, sipas të gjitha kritereve. Vlerësimi bëhet mbështetur në thirrjen ku përfshihen kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ngrihet një komision ad hoc i propozuar nga Dekani dhe i miratuar nga Rektori, "Komisioni i vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit akademik", i përbërë nga pedagogë dhe punonjës kërkimorë-shkencorë të brendshëm, të cilët bëjnë përzgjedhjen përfundimtare të personelit akademik ²³³ . Zyra e Burimeve Njerëzore, Këshillimit të Karrieres dhe Jetës Studentore i kalojnë dosjet komisionit ad-hoc, i cili bën vlerësimin dhe përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit. Komisioni ad-hoc nëpërmjet Dekanit ia kalon Rektorit kandidatët e përzgjedhur për emërimin e kandidatit fitues ²³⁴ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Institucioni angazhohet në drejtim të përmirësimit të kushteve të përshtatshme për të realizuara detyrat e gjithsecilit sipas rolit dhe përgjegjësisë. Kapacitetet infrastrukurore ²³⁵ në dispozicion, sallat e departamenteve, zyrat, zyrat individuale të drejtuesve, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (poste pune, kompjuter, sistem kondicionimi dhe ndriçimi) janë tregues të një mjedisi të përshtatshëm. Bazuar në informacionet e marra nga takimet me stafin

²³³ Aneks 2.25 Procedurat e rekrutimit.

²³⁴ Aneks 2.24 Politikat e rekrutimit.

²³⁵ Aneks 2.102 Infrastruktura e Kolegjit Universitar "Wisdom.

	<p>si dhe nga informacioni i siguruar nga RVB rezulton se platforma e-learning si dhe mësimi fizikisht në auditor zhvillohet në përputhje me rregulloret e brendshme si dhe ligjet në fuqi. Këto sigurojnë krijimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për krytjen e detyrave.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” është nën administrimin e Departamentit të Psikologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore. Gjatë takimit me stafin e institucionit konstatohet që Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është njësi që organizon trajnimet periodike në përputhje me kornizën dhe statutin. Po ashtu në drejtim të trajnimeve profesionale që duhet të ofrohet ka një rritje të programeve Erasmus +; të dhënat tregojnë se ka pasur trajnime të tilla si: Trajnimin “Shkrim dhe menaxhim projektsh”²³⁶, Trajnim “Çrregullimi i Stresit Post-Traumatik: Diagnoza, Rrjedha dhe Trajtimi”²³⁷ të ofruara për stafin e KU “Wisdom”, student dhe alumnit (ish student) kanë marrë pjesë në aktivitete të financuar nga Erasmus +. Institucioni krijon mundësi në drejtim të kualifikimit dhe rritjes profesionale nëpërmjet marrëveshjeve të shkëmbimit të stafeve²³⁸ dhe studentëve nga Erasmus +.²³⁹.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni disponon një Plan të Zhvillimit Strategjik të Universitetit ²⁴⁰ në të cilin janë të specifikuar si pjesë përbërëse e tij kualifikimi i mëtejshëm profesional i personelit akademik. Më tej është zbatimi i tyre i cili mundësohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila organizon trajnimet për rritjen dhe zhvillimin e personelit. Mënyra e zhvillimit të tyre është si me pjesëmarrje fizike ashtu dhe me anë të platformës e-learning. Ekipi ofruet i trajnimeve përbëhet si nga trajnues vendas ashtu dhe trajnues të huaj. KU “Wisdom” në bashkëpunim me Njësinë e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë organizon trajnime për kualifikimin e stafit akademik për të përdorur metodat inovative mësimore si: workshop dy ditor me lektorin amerikan PhD. Ronald M. Nate për metodat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor “‘An Economics Professor’s Approach to Teaching a Difficult Subject’ and ‘Economic Freedom and Prosperity – Albania’²⁴¹, leksion i hapur me Prof. Dr. Emilija Stoimenova Canevska në kuadër të zbatimit të</p>

²³⁶ Aneks 2.72 Axhenda dhe relacioni trajnimit “Shkrim dhe menaxhim projektsh”

²³⁷ Aneks 2.73 Relacioni trajnimit “Çrregullimi i Stresit Post Traumatik: Diagnoza, Rrjedha dhe Trajtimi.

²³⁸ Aneks 4.08 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik.

²³⁹ Aneks 4.07 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

²⁴⁰ Aneks 1.03. Plani strategjik i Kolegjit Universitar “Wisdom”

²⁴¹ Aneks 2.70 Axhenda e ëorkshopit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M. Nate.

	memorandumit midis KU” Wisdom” dhe “International Balkan University” North Macedonia. ²⁴²			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	Institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar ²⁴³ . Bazuar në informacionin e dosjes së vet-vlerësimit dhe takimeve apo informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi së lektorët e këtij program studimi mbajnë titullin Profesor dhe Profesor i Asociuar si dhe gradën shkencore “Doktor i Shkencave” ²⁴⁴ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Kolegji Universitar “Wisdom”, si një institucion me numër të vogël studentësh e përmbush këtë kriter nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral. Mësimi në Programin e studimit Msc. në “Psikologji Shkolllore dhe Edukimi” ka në dispozicion salla leksioni, seminari, zyra dhe një sallë laboratorit të cilat kanë infrastrukturën e duhur për një proces normal të të nxënësve ²⁴⁵ . Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor, laptop, whiteboard, platform online dhe të gjitha mjetet e tjera logjistike. Laboratori përmban programet kompjuterike të nevojshme për plotësimin e kërkesave të këtij programi studimit.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise	Mjediset mësimore në KU “Wisdom” janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të tilla si tabela

²⁴² Aneks 2.74 Ftesa dhe relacion për leksionin e hapur me Prof. Dr. Emilija Stoimenova Canevska.

²⁴³ Aneks 2.26 CV e stafit akademik të programit të studimit.

²⁴⁴ Aneks 4.08 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik.

²⁴⁵ Aneks 2.102 Infrastruktura e Kolegjit Universitar “Wisdom”.

<p>të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>whiteboard dhe smartboard, wireless, të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Laboratori i teknologjisë së informacionit²⁴⁶ që është në funksion të zbatimit të këtij program studimi, është i kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe është i aksesueshëm për të gjithë studentët.</p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Ky program studimi profesional zhvillohet në ambientet e KU “Wisdom”, në të cilin vihen në dispozicion salla leksionesh dhe një laborator i teknologjisë së informacionit pajisje elektronike të tilla si tabela Whiteboard dhe smartboard, wireless. Bazuar në specifikat e profilit profesional “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” mjediset në dispozicion janë të favorshëm për të realizuar qëllimet mësimore të lidhura me përvetësimin e dijeve dhe kompetencave të kërkimit shkencore dhe profesional të studentëve.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Mjediset mësimore në KU “Wisdom” janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, të tilla si tabela whiteboard dhe smartboard, wireless, të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimin në kushte bashkëkohore. Laboratori i teknologjisë së informacionit²⁴⁷ që është në funksion të zbatimit të këtij program studimi, është i kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet) dhe është i aksesueshëm për të gjithë studentët.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Institucioni disponon një listë marrëveshjesh me institucione dhe OJF përkatëse për kryerjen e praktikave profesionale pranë tyre²⁴⁸. Rregullorja e praktikës profesionale përcakton detyrat e departamentit, stafit akademik dhe studentëve. Praktikant mësimore profesionale realizohen në institucionet të ndryshme private ose publike me të cilët universiteti ka marrëveshje por dhe që kanë të specifikuar në organikën e tyre funksionin e psikologut shkollor²⁴⁹.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

²⁴⁶ Aneks 2.102 Infrastruktura e Kolegjit Universitar “Wisdom”.

²⁴⁷ Aneks 2.102 Infrastruktura e Kolegjit Universitar “Wisdom”.

²⁴⁸ Aneks 4.09 Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese.

²⁴⁹ Aneks 2.32 Relacion i praktikës profesionale për studentët e programit “Master i Shkencave” në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”.

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bibloteka ka hapësira dhe u jep mundësi studentëve të bëjnë kërkime online apo të studiojnë materiale fizike në një mjedis me hapësira dhe kushte komode për studim. Ajo është e pajisur me tavolina studimin, kompjuter dhe internet pa limit përmes sistemit wi-fi për të gjithë studentët dhe anëtarët e personelit që duan të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës për shfletim të literaturës për nevoja të ndryshme. KU (Wisdom) disponon një Bibliotekë e cila ka një fond librash, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, duke përfshirë edhe tituj të fushave të ndryshme, ndër të cilat ka dhe tituj të fushës së psikologjisë, sociologjisë dhe filozofisë²⁵⁰. Krahas literaturës fizike²⁵¹, institucioni përdor materiale ndihmëse dhe informuese për studentët si dhe forma e leksioneve në Pdf të cilat i vihen në dispozicion studenteve nëpërmjet faqes online. Çdo student ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë²⁵² dhe te aksesit të bibliotekës online Pro-Quest si dhe përdorimit të katalogut elektronik Cobiss. Nett²⁵³.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Kapaciteti që ka biblioteka garanton deri diku mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit. Gjatë vizitës në KU (Wisdom) na u sqarua se punonjësja e bibliotekës mendohej të akomodonte studentët duke alternuar oraret ndërmjet programeve të studimit. Për fushën e psikologjisë janë më shumë libra në versionin online sesa në atë të printuar.</p> <p><i><u>Gvj</u> sugjeron që fakulteti të shtojë përpjekjet për pasjen në dispozicion të më shumë librave të printuar në fushën e "Psikologjisë Shkollore dhe të Edukimit" në gjuhë të huaj dhe shqip.</i></p>

²⁵⁰ Aneks 2.51. Relacion i bibliotekës së KU "Wisdom".

²⁵¹ Aneks 2.50. Lista e teksteve në bibliotekë.

²⁵² Aneks 2.49. Rregullore e Bibliotekës.

²⁵³ Aneks 2.52 Dokument i COBISS.

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Kolegji Universitar “Wisdom” ka vënë në dispozicion bibliotekën online www.ebookcentral.proquest.com ^{254, 255} që lehtëson realizimin me sukses të programit të studimit, të projekteve kërkimore shkencore dhe përgatitjen e tezës së diplomës. KU “Wisdom” bën përpjekje për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit, duke përfutuar edhe nga donacionet e pedagogëve me botimet e tyre.</p> <p><i>GVJ sugjeron një selektim më të kujdesshëm të teksteve të disponueshme në gjuhën shqipe dhe të huaj duke iu referuar standartit të cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Shërbimet e bibliotekës ofrohen pa pagesë për të gjithë studentët e KU “Wisdom” dhe për personelin e institucionit. Për t’u bërë anëtar i bibliotekës mjafton një regjistrin i thjeshtë me një kartë indentiteti dhe një fotografi dhe studenti hap librezën e bibliotekës²⁵⁶. Përmes saj studentët dhe stafi kanë të drejtë të tërheqin libra nga biblioteka për afate të përcaktuara. Biblioteka on-line Proquest dhe Cobiss ofrojnë gjithashtu akses shfrytëzimi të barabartë për të gjithë studentët si fizikisht ashtu dhe në biblioteka on-line. Studentët e këtij program studimi kanë në dispozicion të tyre këto 2 biblioteka online.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Nga vizita në këtë bibliotekë rezultoi se ajo është e pajisur me pajisjet kompjuterike me qëllim kryesor aksesimin e shpejtë të bibliotekave online të institucionit. Kolegji Universitar “Wisdom” parashikon një buxhetin vjetor për pasurimin me literaturë të fundit në bazë të kërkesave të stafit akademik paraqitur nga Departamenti i Psikologjisë realizohet në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Kolegjit Universitar “Wisdom”, sipas kërkesave të hartuara nga stafi akademik i departamentit të psikologjisë për shtimin e titujve në bibliotekë në mbështetje të programit të studimit “Master i Shkencave” në “Psikologji Shkolllore dhe Edukimi”.²⁵⁷</p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni duhet të bëjë përpjekje që të krijojë kushte për personelin dhe studentët që të kenë në dispozicion një literaturë të përditësuar dhe të pasur në tituj nga shtëpi botuese prestigjioze ndërkombëtare në fushën e psikologjisë shkolllore dhe të edukimit, si dhe të krijojë mundësi për abonimin në një revistë</i></p>

²⁵⁴ Aneks 2.101 Të dhëna të plota përplatformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online.

²⁵⁵ Aneks 2.53 Kontrat blerje Proquest.

²⁵⁶ Aneks 2.49. Rregullore e Bibliotekës.

²⁵⁷ Aneks 2.55 Propozim dhe vendim për blerjen e titujve në Bibliotekë.

	<i>shkencore ndërkombëtare me parametra cilësore, për secilin nga profilet e këtij programi studimi.</i>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Biblioteka qëndron e hapur cdo ditë nga ora 08.30 – 19.30, por gjatë sezonit të provimeve ky orar zgjatej më shumë. Zakonisht këto orare janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, duke krijuar në këtë mënyrë kushte optimale për akses tek fondi i saj në cdo kohë që iu nevojitet. Hapësira fizike dhe kapaciteti i saj i jepnin mundësi një numri të konsiderueshëm studentësh për shfrytëzim të ambjenteve në të njëjtën kohë, dhe duke pasur mundësi për shfrytëzimin e disa këndeve të saj që të lejonin të punojë në privatësi dhe pa u shpërqëndruar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sekretaria mësimore e KU “Wisdom” administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelore në formatin hard copy dhe elektronikisht ²⁵⁸ . Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se menaxhimi dhe administrimi i gjithë informacionin që lidhet me studentët ndër vite kryhet nga Sekretaria mësimore (kryesekretaria e fakultetit) si dhe nga administrator i përgjithshëm. Të dhënat mbi ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim; statistika vjetore mbi numrin e studentëve të rregjistruar, largimet etj të cilat disponohen dhe elektronikisht janë të rregjistruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Indeksit, Rezultateve Akademike dhe Diplomave.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe	Zyra e Burimeve Njerëzore administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit

²⁵⁸ Aneks 1.07 Rregullore e Sekretarisë Mësimore.

<p>aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit përfaqësohet dhe mund të aksesohen nga Departamenti i Psikologjisë. Platforma elektronike Microsoft teams lehtëson ndërveprimin e stafit me studentët, në disa drejtime: Materialet e hedhura nga stafi akademik për lëndët dhe modulet e ndryshme, material shtesë, pikë dhe vlerësimet e studentëve në lëndë të ndryshme jepen individualisht. Ai informon studentët për pikët dhe notat on-line në kohë reale. Gjithashtu, ky sistem lejon ruajtjen e dokumentacionit dhe aktivitetet e personelit akademik. Ky sistem është në funksion kryesisht të procesit të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit të universitetit http://portal.hstalb.xyz/, është i aksesueshëm nga persona të autorizuar dhe gjithashtu mund të krijohen kushte për akses në informacione e dokumenta për studentët sipas rregullave dhe në zbatim të ligjeve mbi privatësinë dhe ruajtjen e të dhënave personale. Nga sistemi i brendshëm i institucionit mund të aksesohen dokumentacion përkatës për stafin akademik dhe studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni dhe vizita në institucion konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion për komunikimin interaktiv të stafit akademik dhe studentëve platformën http://portal.hstalb.xyz/ dhe "Microsoft Teams" i cili siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, akses i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin, por jo në materialet e lëndëve që nuk i përkasin. Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta; Çdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse. Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forum diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Po ashtu institucioni ruan dhe komunikimin dhe koordinimin midis stafit akademik dhe studentëve si fizikisht ashtu dhe me anë të kontakteve telefonike dhe e-maileve zyrtare të tyre.</p>



<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Ky sistem menaxhimi i platformës Microsoft teams, garanton monitorimin në kohë reale të një sër aktivitetesh që lidhen me mbarëvajtjen e procesit akademik online përmes statistikave numerike të gjeneruara prej tij. Në fund të çdo semestri gjenerohen statistika përshkruese në lidhje me përdorimin e sistemit nga stafi akademik. Këto të dhëna i vihen në dispozicion përgjegjës të departamentit, organeve drejtuese dhe personave të tjerë përgjegjës për monitorimin e ecurisë së procesit mësimor online.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Në faqen zyrtare të KU “Wisdom” www.wisdom.edu.al paraqitet një informacion i plotë mbi filozofinë dhe misionin, partnerët, drejtimin dhe funksionimin, organigramën; guidat për studentët e ardhshëm të kolegjit si dhe mbi programet, së bashku me bio të detajuara të personelit akademik etj. Përmes saj, por edhe rrjeteve sociale, kolegji promovon veprimtaritë e ndryshme me karakter akademik por edhe social-kulturor. Kjo faqe bën publikimin në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>GVJ konstatoi që plani i financimit të progamit hartohet duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore²⁵⁹ edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet në drejtimin që ato do përdoren. Kolegji Universitar “Wisdom” harton pasqyra dhe raporte financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat përfshihen dhe në plan buxhetin e institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve</p>	<p>Plani i financimit të programit të studimit²⁶⁰ përfshin në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet,</p>

²⁵⁹ Aneks 2.100 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit.

²⁶⁰ Aneks 2.100 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit.



<p>njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si edhe aksesin në bibliotekat on-line. Ky plan financimi i programit të studimit Msc. në "Psikologji Shkollore dhe Edukimi" është hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet në drejtimin që ato do përdoren.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Institucioni kryen auditim të përvitshëm bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni kryen auditim të brendshëm me anë të Zyrës së Auditit të brendshëm si dhe auditim të jashtëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare. Zyra e Auditit të brendshëm është njësi administrative e ngritur dhe funksionale brenda institucionit e cila ka si mision kontrollin e procedurave dhe rregullave të vendosura në rregulloren e funksionimit të zyrës së financës dhe auditit të brendshëm. U konstatua se raportet e këtyre dy llojeve të auditimeve marrin në analizë eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve²⁶¹. Hartimi i një raporti në lidhje me transparencën financiare i jep mundësi institucionit të këtë një opinion ligjor të pavarur mbi pasqyrat financiare në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit²⁶².</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e</p>	<p>Në lidhje me raportin financiar për këtë program studimi evidencat tregojnë që institucioni ka burime në dispozicion për financimin e programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij²⁶³. Gjatë vizitës në institucion na u paraqit procedura që ndjek institucioni. Ai përmes departamentit studion tregun e punës, nëse</p>

²⁶¹ Aneks 2.91 Projekt buxheti.

²⁶² Aneks 2.92 Pasqyra financiare.

²⁶³ Aneks 2.100 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit.

posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	ka pritshmëri për të ardhmen dhe bën një plan biznes. Nëse pritshmëritë janë të larta atëherë programi i studimit mbështetet financiarisht. Pritshmëritë ishin pozitive dhe ishte marrë vendimi për ta mbështetur këtë program studimi			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	GVJ në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe vizitës pranë KU "Wisdom" ka konkluduar se raportet financiare të institucionit janë të dokumentuara për të tre vitet e fundit. Raporti financiar i cili përgatitet nga Rektorati dhe miratohet nga Bordi i Administrimit bazohet në planifikimet e kryera në programimin financiar. Sipas këtij raporti programi i studimit dëshmon qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete të mjaftueshme për sigurimin në vijimësi të përmirësimit në të gjitha aspektet, veprimtarinë e institucionit më qëllim rritjen e cilësisë akademike ²⁶⁴ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomiminë programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencialë, nëpërmjet komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Gjithashtu informacion mbi organigramën e Fakultetit, dhe strukturën e programit të studimit afishohet në standat e kolegjit si edhe një informacion më pak i

²⁶⁴ Aneks 2.100 Të dhëna nga plani i financimit të programit të studimit.

	<p>detajuar shfaqet në faqen e internetit të KU Wisdom. Ky program studimi është organizuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në fuqi. Dhe të gjitha procedurat që lidhen me pranimin²⁶⁵ dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme e këtij programi studimi. Informacioni për kriteret dhe kuotat e pranimit²⁶⁶, procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve.²⁶⁷.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar DVV dhe vizitës në insitucion GVJ konstaton se institucioni mbështetet në rregulloren e tij, procedurën e transferimit²⁶⁸, për të rregulluar në përputhje me ligjet në vend nga hyrja në dalje. Kandidati duke ndjekur një procedurë të caktuar dhe në afatet ligjore të përcaktuara me ligj mund të kryej ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me të drejta të plota për të gjithë. Të gjitha procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve²⁶⁹ deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendëshme e këtij programi studimi. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online²⁷⁰, në broshurën informuese dhe është pjesë e fushatave informuese përmes fletëpalosjeve.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumenteve të vëna në dispozicion, përse i përket kriterëve dhe procedurave të pranimit e përzgjedhjes së studentëve²⁷¹, përparimit përgjatë kursit të studimit të ciklit të dytë, aksesohen lehtësisht nga të interesuarit. Në faqen zyrtare të institucionit janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimit bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve që fiton studenti. E gjithë procedura është paraqitur në mënyrë transparente. Procedurat që lidhen me transferimin, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve</p>

²⁶⁵ Aneks 2.14 Vendim Senati për kriteret e pranimit për vitin akademik 2020-2021.

²⁶⁶ Aneks 2.13 Vendim Senati “Mbimiratimin e kuotave të pranimit të studentëve me kohë të plotë të programeve të studimit për vitin akademik 2020-2021.”

²⁶⁷ Aneks 1.13. Politikat institucionale të publikimit të informacionit.

²⁶⁸ Dokumenti 39. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin.

²⁶⁹ Dokumenti 36. Të dhënat për cilësinë në hyrje dhe dalje Ba Psikologji.

²⁷⁰ Aneks 1.12. Të dhënat nga faqja zyrtare e WEB.

²⁷¹ Aneks 2.14 Vendim Senati për kriteret e pranimit për vitin akademik 2020-2021.

	dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku përmes informacionit në faqen e KU “Wisdom” mbi këtë procedurë dhe dokumentat e kërkuar për transferimin e studimeve konform rregullave dhe ligjeve në fuqi. ²⁷² .			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	KU “Wisdom” në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin e Senatit ²⁷³ ka miratuar kriteret e pranimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, dhe i pasqyron këto informacione edhe në faqen zyrtare duke i mundësuar aksesin kujtdo që është i interesuar në çdo kohë. Pranimi i studentëve në programin Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” është rregulluar nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave, me anë të të cilit vendoset nota mesatare në hyrje për çdo vit akademik.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Institucioni angazhohet përmes një sërë formash në promovimin dhe reklamimin e programeve të studimit në kushtet e pandemisë kryesisht duke përdorur faqen zyrtare të webit ²⁷⁴ . dhe faqen zyrtare në facebook ²⁷⁵ Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi, për të gjithë të interesuarit që duan të vazhdojnë studimet e tyre në KU “Wisdom”. Format, me të cilat realizohen udhëzimi i studentëve, në lidhje me kriteret e përgjithshme/të veçanta, për t’u regjistruar në programin e “Psikologjisë Shkollore dhe të Edukimit”, janë të shumta si këshillimi në ambjentet e KU “Wisdom” gjatë periudhës së regjistrimeve, etj. <i>GVJ sugjeron për njësinë bazë që të shoh mundësinë e vendosjes së kriterëve të vecanta për përzgjedhjen e kandidatëve për të vijuar studimet në MSc për “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” me vijimësi në ciklin e parë të studimeve ne Psikologji me qëllim që të lehtësohet jo vetëm trasmetimi i dijeve dhe njohurive në auditor për një grup homogjen studentësh por edhe të lehtësohet licensimi nga Urdhri i Psikologut, për studentët në përfundim të studimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

²⁷² Aneks 2.33. Rregullore e transferimeve.

²⁷³ Aneks 2.14 Vendim Senati për kriteret e pranimit për vitin akademik 2020-2021.

²⁷⁴ www.wisdom.edu.al (aksesuar më 09.05.2021).

²⁷⁵ <https://www.facebook.com/universitetiwisdomofficial>(aksesuar më 09.05.2021).

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit ²⁷⁶ akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore, por edhe takimet informuese që realizohen ditët e para të fillimit të vitit akademik, lehtësojnë njohjen e studentit me këto procedura.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet “Java e Orientimit”, e cila është e përvitshme në kolegji. Gjatë kësaj jave realizohen takime, leksione të hapura për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të KU Wisdom-it. Në çdo lëndë apo modul janë përcaktuar qartë të gjitha informacionet që lidhen me procedurat që ndjek institucioni për vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni ka procedura të unifikuara për të gjithë njësitë e tij, të cilat janë të bazuara në udhëzimet e MASR për strukturën e hartimit të silabusit të lëndës ²⁷⁷ . Njësia bazë përmes strukturave të saj informon studentët e programit profesional përgjatë fundit të semestrit të parë dhe fillimit të semestrit të dytë në lidhje me Provimin e diplomës ²⁷⁸ . Për provimin e përgjithshëm përfundimtar jepet një udhëzim në lidhje me tematikat e përfshira. Fazat kohore të mbrojtjes së diplomës përmes provimit me shkrim bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Monitorimin e këtyre procedurave që lidhen me provimin e përgjithshëm përfundimtarë e realizon koordinatori dhe drejtuesi i njësisë bazë.
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se në rregulloren e diplomimit, studenti njihet me udhëzime të specifikuara lidhur me strukturën e punimit të diplomës, i cili është gjithashtu është pjesë e prezantimit

²⁷⁶ Aneks 2.07 Rregullore e Departamentit të Psikologjisë Neni 40, pika 1.

²⁷⁷ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

²⁷⁸ Aneks 3.05 Rregullore e diplomimit.

dhe diplomimit në programin e studimit.	që bëhet në fillim të vitit akademik. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Monitorimin e këtyre procedurave që lidhen me mbrojtjen e diplomës me temë e realizon koordinatori i Departamentit në bashkëpunim me njëzinë bazë dhe stafin akademik.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Institucioni ndjek politika që synojnë reklamimin dhe promovimin e tij në vazhdimësi ²⁷⁹ . Në lidhje me tërheqjen e studentëve të rinj çdo fillim vitit akademik KU "Wisdom" organizon grupe pune të përbëra nga pedagogë të cilët informojnë studentët me programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t'i ndihmuar ata në vendimarrje ²⁸⁰ . Format si; njoftimet në faqen zyrtare të web, rrjetet sociale, standat e Kolegjit dhe guidës së studentit ndërmerren me qëllim tërheqjen e studentëve të interesuar. Gjithashtu kolegji merr pjesë në panairt e karrierës ²⁸¹ . Zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore organizon çdo fillim viti ditët e orientimit ²⁸² gjatë të cilave studentët njihen mbi programin e studimit si dhe strukturat e Kolegjit Universitar "Wisdom".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Referuar RVB-së, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve përmes një morie formash. Duke nisur me informacionin në faqen online të KU "Wisdom"-it, përmes kontratës që nënshkruan, informacionit që merr nga zyra e Kujdesit për studentët, këshillimit nga stafi akademik në faza të ndryshme si dhe rregullore mësimore të programit të studimit.

²⁷⁹ Aneks 2.86 Guida e studentit.

²⁸⁰ Aneks 2.31 Udhëzuesi didaktik i Programit Master Shkencor në "Psikologji Shkollore dhe Edukimi".

²⁸¹ Aneks 2.87 Relacion për pjesëmarrjen në ditët e informimit dhe panairt.

²⁸² Aneks 2.88 Relacion për ditët e orientimit.

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Në dispozicion të studentëve të programeve të studimit aksesit tek informacioni mbi kurrikulën dhe programin e studimit mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së rregjistrimit, gjatë ditëve të orientimit, Departamenti i Psikologjisë në bashkëpunim me Zyrën e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore, organizon takime informuese²⁸³ me studentët si dhe u prezanton studentëve Udhëzuesin Didaktik²⁸⁴. Gjithashtu duke përdorur 2 platformat digjitale studentët mund të marrin informacion për lëndët që do të zhvillojnë përgjatë semstrit dhe vitit akademik. Silabuset e lëndëve mësimore²⁸⁵ përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka në dispozicion të orientimit profesional të studentëve Zyrën e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre duke bashkëpunuar ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti. Gjithashtu, në KU “Wisdom” realizohen trajnime të ndyshme mbi aftësimin me shprehi për kërkimin e punës²⁸⁶. Përshirja e bordit të punës në një sërë aktivitetesh me alumnit duke kontribuar kryesisht në çështjet e lidhura me praktikën profesionale ka një impakt pozitiv në përmirësimin e këtij programi studimi. Organizimi i panairëve të punës dhe aktiviteteve të tilla si leksione të hapura me aktorë nga tregu i punës si pjesë e realizimit të praktikës profesionale janë veprimtari që synojnë të qartësojnë studentët dhe të orientojnë rreth mundësive për punësimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Sistemi online siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, aksesit i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin por jo në materialet e lëndëve që nuk i përkasin. Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta, cdo pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë literaturën e lëndëve përkatëse.</p>

²⁸³ Aneks 2.88 Relacion për ditët e orientimit.

²⁸⁴ Aneks 2.31 Udhëzuesi didaktik i Programit Master Shkencor në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”.

²⁸⁵ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

²⁸⁶ Aneks 2.89 Relacion i Zyrës së Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore për trajnimin me temë “ Si të realizojmë një aplikim për punë”

<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimi të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Çdo informacion aksesohet nga cilido i interesuar në kohë reale.</p>			
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>GVJ konkludoi se institucioni siguron informacion të arritshëm edhe në distancë për studentët me anë të: faqes zyrtare të webit komunikimi në vijimësi në nivel departamenti, njoftimi përmes platformës Teams dhe adresave të email si dhe njoftimeve në rrjetet sociale. Përmes platformës on-line, institucioni ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Ky sistem ka rezultuar i dobishëm vecanërisht përgjatë këtij viti akademik si pasojë e pandemisë Covid 19, ku aksesimi ka qenë gati 100% nga studentët, sic shprehen pedagogët gjatë takimit. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimi të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Çdo informacion aksesohet nga cilido i interesuar në kohë reale. Gjatë intervistës me stafin akademik por edhe grupin e punës na u referua se cdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorin e teknologjisë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga



pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me numrin e studentëve të diplomuar dhe cilësinë në dalje. Nga të dhënat që kemi në dispozicion për këtë program studimi për 3 vitet e fundit, konstatojmë se numri i studentëve të diplomuar ka pësuar luhajtje përgjatë viteve. ²⁸⁷ Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi per dy vitet akademike është: Për vitin akademik 2020-2021 9 studente; Për vitin akademik 2019-2020 12 studente; Totali për një cikël studimi 21 studente;
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” ²⁸⁸ . Ajo cfarë vihet re duke u bazuar tek stasiskat është se ulja e numrit të studentëve të rregjistruar për herë të parë në vitin e parë, nga 18 studentë të rregjistruar në vitin e parë për vitin akademik 2018-2019, në 12 studentë të rregjistruar në vitin e parë për vitin akademik 2019-2020 dhe 9 student të rregjistruar në vitin e parë për vitin akademik 2020-2021. Ndërsa numri i të larguarve është rezulton me nga 3 ose 1 student ndër vitet akademike.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Statistikat për ecurinë e studentëve janë të pasqyruara përgjatë 2 viteve akademike në të cilat ky program ka zhvilluar veprimtarinë. Të dhënat fokusohen në numrin e studentëve sipas viteve të studimit, nota mesatare e hyrjes dhe e daljes, student të transferuar sipas viteve në fashën e 3 viteve ²⁸⁹ . Referuar statistikës kemi një rritje të notës mesatare në dalje për studentët e këtij programi studimi. ²⁹⁰
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes	Zyra që merret me regjistrimin e studentëve, sekretaria mësimore janë strukturat e posaçme që merren me ruajtje dhe menaxhimin e

²⁸⁷ Aneks 2.96 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje.

²⁸⁸ Aneksi 2.95. Të dhëna të plota për regjistrimin.

²⁸⁹ Aneksi 2.95. Të dhëna të plota për regjistrimin.

²⁹⁰ Aneks 2.96 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje

<p>sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>të dhënave statistikore nga hyrja deri në dalje. Punën e tyre në drejtim të menaxhimit të rekordeve të studentëve e realizojnë edhe përmes sistemit informatik të regjistrave dhe arkivave të të dhënave të plota²⁹¹. Këto të dhëna disponohen për të gjithë studentët e Ku “Wisdom”. Studenti ka dosjen personale, e cila ka të gjitha të dhënat që janë marrë në fazën e regjistrimit dhe vazhdojnë të përditësohen në vijim përgjatë viteve të studimit. Personat e autorizuar mbështeten në sistemin informatik për të gjeneruar statistika mbi studentët në mënyrë të shpejtë dhe të saktë.²⁹².</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Referuar raportit të departamentit²⁹³ mbi punën e tij për vitin akademik 2019-2020 ka një qëndrim pozitiv mbi vijimësinë e këtij programi dhe gjithashtu shihet si tregues pozitiv interesimi i studentëve që ndikon në prurje me cilësi edhe pse kjo njëkohësisht kushtet e pandemisë kanë ndikuar në reduktimin shumë numrin e studentëve²⁹⁴. Gjithashtu, departamenti disponon evidenca mbi shkallën e punësimit të tyre²⁹⁵ dhe referuar këtyre të fundit panorama shihet pozitive, vitin e fundit akademik numri i studentëve të këtij programi studimi që janë të punësuar brenda profilit është i konsiderueshëm (4 studentë të punësuar brenda profilit, 1 student i vetëpunësuar, 1 pa informacion, 1 i pa punë).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse</p>	<p>Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si këshillin e studentëve²⁹⁶, i cili është grupim i studentëve dhe përzgjedh</p>

²⁹¹ Aneks 2.96 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje.

²⁹² Aneksi 2.95. Të dhëna të plota për regjistrimin.

²⁹³ Aneks 2.12 Analizë vjetore e Departamentit të Psikologjisë 2019-2020.

²⁹⁴ Aneks 2.96 Të dhëna të plota për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje.

²⁹⁵ Aneks 2.97 Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve.

²⁹⁶ Aneks 2.83 Rregullore e Këshillit Studentor.



<p>e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të KU “Wisdom”²⁹⁷. Përfshirja e studentëve në një sër strukturash vendimarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përcaktuar në aktet ligjore dhe rregulloren dhe statutin e vetë IAL-it.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në të gjitha strukturat ku përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve²⁹⁸. Ato janë pjesë aktive e mbedhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë²⁹⁹, dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari³⁰⁰. Studentët janë të përfshirë në grupime studentore në lidhje me fushën e studimit dhe sipas interesave personale. Studentët janë të përfshirë në grupime studentore siç është Klubi Ligji dhe Demokracia, Klubi i Sipërmarrësve Studentorë, Klubi Jeta Studentore dhe Klubi i Vullnetarëve në Shqipëri. Në lidhje me vlerësimin e stafit akademik studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogut përmes pyetësorëve dhe përmes takimeve në grup.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ngarkesa akademike e studentëve në këtë program studimi është hartuar dhe zbatohet duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore të institucionit dhe në harmoni me udhëzimet dhe vendimet e MASR. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesa e shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra (afërsisht 30 ECTS për semestër). Ka rregullore dhe procedura që lehtësojnë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme të realizuara më parë ose më pas nga studenti. Grupi i Vlerësimit të jashtëm konstatoi se programet e studimit janë hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve Statuti i KU “Wisdom” dhe rregulloret përkatëse parashikojnë procedura joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit.³⁰¹</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe</p>	<p>Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to evidentohet duke iu referuar edhe përvojës së KU “Wisdom” realizoi takime me Alumnit³⁰² mbi kurrikulën mësimore madje, referuar këtij procesi ka</p>

²⁹⁷ Aneks 2.16 Vendim për emërimin e anëtarëve të Senatit Akademik.

²⁹⁸ Aneks 2.17 Vendim për emërimin e anëtarëve të komisioneve të përhershme.

²⁹⁹ Aneks 2.15 Vendim për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

³⁰⁰ Aneks 2.18 Vendim për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Etikës.

³⁰¹ Aneks 1.02 Rregullore e Kolegjit Universitar “Wisdom”.

³⁰² Aneks 2.60 Axhend dhe relacioni takimit me Alumnin.

reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	një kërkesë nga ana e studentit për përmirësimin cilësor të kurrikulës së këtij programi studimi me lëndë, të cilat të kenë më shumë hapsirë për praktikën profesionale. Një tjetër aspect që lidhet me përfshirjen e tyre është edhe takimi i njësisë bazë me student e pedagogë mbi cilësinë në mësimdhënie ³⁰³ .			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës	Studentëve u mundësohet një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të programit të studimit. Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seanceve sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm. Studentët kanë mundësi të parashtrajnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Pjesëmarrja e personelit akademik në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor dhe mobiliteteve shihen me ndikim pozitiv ³⁰⁴ . Këto të dhëna dokumentohen dhe përfshihen në evidence që mund të përdoren për nevoja të ndryshme nga ana e institucionit. Personeli akademik i Departamentit të Psikologjisë është i angazhuar në implementimin e një sërë aktiviteteve kërkimore - shkencore. Kjo klimë ka ndikim pozitiv jo vetëm në drejtim të rritjes së kapaciteteve njerëzore të institucionit por edhe të cilësisë në mësimdhënie ³⁰⁵ .
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim	KU "Wisdom" përmes Njësisë së Kërkimit Shkencor ka krijuar 65 partneritete me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të

³⁰³ Aneks 2.40. Relacion takimi i departamentit të psikologjisë me studentët.

³⁰⁴ Analiza 4.04 Analizë vjetore e Njësisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

³⁰⁵ Aneks 4.08 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.

<p>realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>përbashkëta³⁰⁶. Institucioni ka lidhur 80 marrëveshje partneriteti në tre vitet e fundit, me një pjesë të të cilëve ka patur edhe aktivite të përbashkëta në drejtim të organizimit të konferencave shkencore ndërkombëtare, siç është Universiteti La Sapienza, Romë, në kuadrin e Projektit ERASMUS +, International Balcan University, Kolegji European i Kosovës, Universiteti i Kalabrisë nëpërmjet pjesëmarjes së pedagogëve të këtyre partnerëve ndërkombëtarë³⁰⁷ si lektorë të huaj të ftuar, ose duke i përfshirë në Bordin Shkencor ose Organizativ të Konferencave³⁰⁸</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Personeli akademik i Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” motivon studentët të angazhohen në hulumtime dhe projekte kërkimore, të shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore për të cilat bashkëpunojnë në kuadër të temës së diplomës. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në aktivitete të ndyshme që synojnë fitimin e kompetencave për të realizuar kërkim shkencor³⁰⁹. Motivohen dhe mbështeten për të marrë pjesë në konferencat studentore të cilat janë të përvitshme në KU “Wisdom”^{310, 311}.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Në funksion të nevojave të stafit akademik dhe të studentëve të programit të studimit Msc. në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” është revista shkencore “Wisdom” e cila mund të shfrytëzohet për publikim falas të artikujve nga ana e të gjitha palëve të interesuara³¹². Gjithashtu vlen të theksohet se institucioni në drejtim të mbështetjes së stafit akademik për të publikuar në revista ndërkombëtare ka nënshkruar një marrëveshje edhe me institucione ndërkombëtare.³¹³</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Edhe pse kemi evidence të dukshme lidhur me mbështetjen e stafit akademik në projekte të ndyshme kombëtare dhe ndërkombëtare, krijohen kushte për përfshirjen e studentëve në procese të caktuara pune përgjatë fazës së implementimit të tyre. Megjithatë kemi pak evidence për të gjykuar në terma real lidhur me përfitimin e tyre në këtë aspekt.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për</p>	<p>Personeli akademik ka një rol aktiv përgjatë gjithë këtij procesi duke mbështetur studentët në gjenerimin e ideve dhe përzgjedhjen</p>

³⁰⁶ Aneks 4.09 Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese.

³⁰⁷ Aneks 4.07 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.

³⁰⁸ Analiza 4.04 Analizë vjetore e Njësisë së Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

³⁰⁹ Aneks 2.69 Relacion i ëorkshop “Përse bëjmë kërkim shkencor”.

³¹⁰ Aneks 2.61 Axhenda e konferencës studentore “Sfidat e reja në psikologjinë dhe ekonominë moderne”

³¹¹ Aneks 2.62 Axhenda e konferencës ndërstudentor “Impakti psikosocial dhe ekonomik i Covid-19”.

³¹² Aneks 2.56. Relacion i përfshirjes së stafit në projekte.

³¹³ Aneks 4.06. Propozim dhe vendim për fondin e kërkimit shkencor.

kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	e fushës së tyre kërkimore, ofron asistencën e nevojshme për përcaktimin e metodologjisë së punës dhe kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës. Ky rol diktohet edhe nga rregullorja e diplomimit ³¹⁴ dhe monitorohet nga strukturat e njësisë bazë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.7

Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Në raport me politikat e institucionit për sigurimin e bashkëpunimit me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare ³¹⁵ dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit kemi disa element të dallueshëm. Institucioni ka miratur një grup pune që drejton Njësinë e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë ku janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme. Struktura në fjalë e realizon punën e saj duke u mbështetur në një bashkëpunim të rëndësishëm që ka rritur mobilitetin e stafit akademik, ³¹⁶ , ³¹⁷ , zhvillimin e leksioneve të hapura ³¹⁸ dhe u kanë dhënë mundësi studentëve të jenë pjesëmarrës në një sërë aktiviteteve ndërkombëtare ku KU "Wisdom" ka qenë partner.
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Modulet e lëndëve të caktuara të cilat realizohen nga studentët përgjatë ndjekjes së këtij program studimi, ³¹⁹ kanë një impakt të dukshëm në zhvillimin e kompetencave për të kryer kërkime shkencore dhe për të ndihmuar në implementimin e në projekteve të ndryshme ³²⁰ me impakt në konteksim komunitare dhe të shoqërisë tonë. Kjo përvojë profesionale shënon një moment të rëndësishëm të rritjes së kompetencave personale në drejtim të përdorimit të

³¹⁴ Aneks 3.05 Rregullore e diplomimit.

³¹⁵ Aneks 4.10 Marrëveshjet e bashkëpunimit.

³¹⁶ Aneks 2.80 Aplikimi dhe pranim aplikimi për mobility projekt me Split, Kroaci.

³¹⁷ Aneks 2.90 Relacion mbi pjesëmarrjen në trajnimin "Gender based and sexual violence in love relationships of youngsters" në Mal të Zi.

³¹⁸ Aneks 2.75 Relacion leksion i hapur me Dr. Marija Stojanova.

³¹⁹ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

³²⁰ Aneks 2.56. Relacion i përfshirjes së stafit në projekte.

	metodave të kërkimit nga studentët që u siguron vijueshmëri dhe përgatitje për ciklin e tretë të studimeve.
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së stafit të tij akademik dhe studiuesve të rinj të cilët janë pjesë e sturkturave të tij në projekte kërkimore vendës dhe të huaj ³²¹ . Duke iu referuar statistikave të vëna në dispozicion nga KU "Wisdom" kemi një sër aktivitetesh që dëshmojnë këtë fakt si përfshirja e pedagogëve të departamentit të Psikologjisë si ekspertë në këto projektet: - Shmangia e recedvizmit, Cultural studies in business' -Fëmijë të sigurtë dhe të shëndetshëm -Social inclusion through the multi-functional center in Prrenjas, Sadi Haliti" -Children card to strengthen children rights - Sporti si instrument integrimi për gratë, dance sportive -Të rinjtë e Tiranës në vendimmarrje nëpërmjet aplikacionit smart - Studime Kulturore në Biznes" me numër reference 2018-1-IT02- KA203-048091 ³²² .
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Fryrma e bashkëpunimit me institucionet e huaja shihet në aktivitetet e ndërmarra në kuadër të lehtësimit të mobilitetit të personelit akademik për të krijuar eksperiencë profesionale jashtë, por gjithashtu kemi edhe akses për stafin akademik të huaj në KU "Wisdom" përmes organizimit të orëve të hapura, organizimit të konferencave të përbashkëta shkencore ³²³ . Megjithatë tregues të matshëm në këtë drejtim duhen konsideruar bashkëpunimet në projekte të përbashkëta ³²⁴ që realisht krijojnë një mundësi reale për kërkuesit e huaj, ku KU "Wisdom" ka zhvilluar një numër të caktuar që vlen për tu vlersuar.
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Institucioni ka ndjekur një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare të zhvilluar në ambjentet e KU "Wisdom" si pjesëmarrja në trajnime ³²⁵ dhe leksion të hapur ³²⁶ , workshop ³²⁷ e konferenca etj. Të gjitha këto aktivitete janë në mbështetje të nevojave të studentëve për tu njohur dhe për të krahasuar cilësinë e mësimdhënësit dhe të kërkuesit shkencor.
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fiton për	Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, ka pasur të ftuar për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik të

³²¹ Aneks 2.56. Relacion i përfshirjes së stafit në projekte.

³²² Aneks 4.10 Marrëveshjet e bashkëpunimit.

³²³ Aneks 4.10 Marrëveshjet e bashkëpunimit.

³²⁴ Aneks 2.56. Relacion i përfshirjes së stafit në projekte.

³²⁵ Aneks 2.90 Relacion mbi pjesëmarrjen në trajnimin "Gender based and sexual violence in love relationships of youngsters" në Mal të Zi.

³²⁶ Aneks 2.74 Ftesa dhe relacion për leksionin e hapur me Prof. Dr. Emilija Stoimenova Canevska.

³²⁷ Aneks 2.70 Axhenda e ëorkshoptit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M. Nate.

veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	huaj ^{328, 329, 330} kryesisht në kuadër të projekteve Erasmus +, por përsa studentë të huaj, në përgjithësi infrastruktura në universitetet tona nuk të lejon mundësinë e shfrytëzimit të këtyre politikave të Bashkimit Evropian që promovon ndërkulturalitetin dhe motivon studentët dhe stafin të shkëmbejnë përvoja dhe eksperiencat midis tyre, kjo edhe e ndikuar nga fakti që në shumicën dërrmuese të universiteteve nuk ka kurse që ofrohen në gjuhë të huaj.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedurë e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedurë e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni ka zyrën e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore e cila është në shërbim të informimit të studentëve. Ajo që vihet re është që ka një njohje jo të plotë dhe të detajuar të funksionit të kësaj zyre. Kjo zyrë përdor faqen zyrtare e webit www.wisdom.edu.al ku pasqyron aktivitetet që zhvillohen në Kolegjin Universitar "Wisdom" dhe përditëson informacione të detajuara për studentët, stafin dhe palët e treta. Institucioni është aktiv dhe në rrjetet sociale. <i>Në këtë kontekst GVJ sugjeron që të punohet më shumë në drejtim të njohjes dhe promovimit të kësaj zyre.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me	Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion vihet re se veprimtaria e kordinatorit të programit, njësia bazë dhe zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës

³²⁸ Aneks 2.75 Relacion leksion i hapur me Dr. Marija Stojanova.

³²⁹ Aneks 2.74 Ftesa dhe relacion për leksionin e hapur me Prof. Dr. Emilija Stoimenova Canevska.

³³⁰ Aneks 2.70 Axhenda e ëorkshopit të organizuar me pedagogun amerikan Ronald M. Nate.

<p>procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Studentore orientohen drejt informimit të studentëve dhe këshillimit të tyre në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre ofron, mundësitë e punësimit në të ardhmen, etj. Po ashtu ky intitucion me qëllim mbështetjen profesionalisht të studentëve dhe ti ndihmojë ata në planifikimin e karrierës ofron dhe udhëheqje dhe kujdestari (tutorat) për studentët, dhe përgjegjëse për këtë është zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore e cila ofron mbështetje në drejtim të koordinimit dhe mbështetjes ndaj studentëve për tu orientuar në tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore /specifikisht njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Në KU "Wisdom" funksionon Alumni, me të cilët bëhen takime të përvitshme për të marrë mendime, ndarë eksperiencë në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës. "Ditët e Karrierës" janë gjithashtu veprimtari të përvitshme të cilat synojnë të ndihmojnë studentët në fazat e ndryshme të vendimarrjes për zgjedhjen e karrierës profesionale në linjë me mundësitë, nevojat dhe aftësitë personale të tyre. Këto aktivitete orientojnë studentët në përzgjedhjen e profilit, dhe më pas në lehtësimin e përzgjedhjes së institucioneve të zhvillimit të praktikës profesionale në linjë me programin e studimit. Seminare të hapura, lektorë të ftuar janë pjesë e promovimit të profesioneve të ndryshme për studentët e saj. Këshilluesi i karrierës është në dispozicion të studentëve gjatë gjithë javës dhe ofron një sër shërbimesh si këshillim karriere, informacion mbi vende të lira pune, informacion mbi praktikën profesionale, informacion në lidhje me trajnimet dhe workshop-et etj.</p>



<p>Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore Këshillimit të Karrierës dhe Jetës Studentore është një strukturë e ngritur e cila funksionon në bazë të statutit të Kolegjit Universitar “Wisdom” e cila ka si objektiv të punës së saj mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë viteve të punësimit. Shpesh luan një rol të rëndësishëm në orientimin e studentit drejt mundësive të punësimit, por edhe në drejtim të ofrimit të këshillimit për karrierën me qëllim vlersimin më objektiv të mundësive që student ka në dispozicion. Kjo zyrë me qëllim që të lehtësojë intinerarin e kalimit nga shkolla në punë përqipet të shfrytëzojë asetet e saj si bordi i punës dhe panairët e punës.</p>
---	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në raport me politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe duke u mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera ligjore, në përputhje me statutin dhe rregulloren e institucionit kemi disa element të dallueshëm. Institucioni ka miratur një grup pune, i cili do të drejtojë këtë strukturë, ku janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme³³¹. Struktura në fjalë e realizon punën e saj³³² duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm për</p>

³³¹ Aneks 2.15 Vendim për ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

³³² Aneks 1.03 Plani Strategjik i Kolegjit Universitar “Wisdom.

	funksionimin e saj siç është Rregullorja për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë ³³³ .
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka nxitur punën që kurrikula të harmonizohet me ligjet e reja për arsimin e lartë. Kjo veprimtari është realizuar përmes vlerësimit të programeve të studimit me qëllim që të harmonizohen sipas ligjeve të reja. Departamentet kanë pasur rolin kryesor në përcaktimin e përmbajtjes së programeve të studimit, punë e cila monitorohet në vijimësi nga zyra e kurrikulës. Një student është pjesë e tij. Grupi i sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë është ngritur me Vendim Senati Akademik. Kjo njësi ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit, ajo organizon punën në bashkëpunim me njësitë bazë, për kontrollin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Institucioni ka aplikuar për akreditim për programin e studimit në ASCAL konform rregullave në fuqi në vendin tonë. Ka ndjekur të gjitha procedurat burokratike që lidhen me këtë proces. ASCAL ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të jashtëm të akreditimit për këtë program studimi, por jo vetëm. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se kolegji i kushton një rëndësi të veçantë rekrutimit të stafit akademik me tituj e grada shkencore. Për sigurimin e cilësisë institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë me studentët, stafin akademik, takimet në grup për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme.
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjsteve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit	Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes planit të saj të veprimit synon që për këto qëllime të realizojë trajnime me stafin akademik dhe administrative me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët. Pjesë e këtyre trajnimeve do të jenë zyra e burimeve njerëzore, njësisë për kërkimin shkencor, departamentet dhe zyra e kujdesit për studentët, zyra e karrierës, kordinatorët e departamenteve dhe senati akademik. Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se në strategjinë e zhvillimit institucional ka politika që synojnë përmirësimin e cilësisë për programin e studimit. Departamenti i

³³³ Aneks 1.06 Rregullore e Njësisës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

	Psikologjisë plotëson raportin e vlerësimit të programit. Në këtë raport paraqiten të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshme të realizuara, planet për ndryshimet dhe përmirësime në të ardhmen, feedbacku i marrë nga studentët, nga personeli akademik i përfshirë në programin e studimit, të dhëna mbi ecurinë e studentëve etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmirësim	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë monitoron punën e departamentit dhe stafit akademik përmes aktiviteteve mbikëqyrëse në lidhje me vlerësimin e përputhshmërisë së silabuseve e me standardet e institucionit për lëndët që zhvilloheshin në programet e studimit. Pas këtij procesi u përcjell departamenteve një draft raport nga ku pritet një reflektim. Këto veprimtari dëshmojnë hapa pozitiv në drejtim të ambicjes institucionale drejt rritjes së cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se institucioni për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit angazhon titullarët, lektorët e lëndëve dhe asistent-lektorët në azhurnimin e syllabuseve në përputhje me të rejtat e fushës së paku në 5 vitet e fundit. Monitorimi nga komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit të ciklit të dytë fokusohet në dy aspekte, monitorimin e mënyrës së ndërtimit të silabusit të lëndës sipas standarteve të institucionit si dhe përmes vlerësimit të procedurave të ndjekura në drejtim të mbarvajtjes së provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare.
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe	GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni përdor metodologji vlerësimi si dhe instrumente matëse vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit "Psikologji Shkollore dhe

mbarëvajtjen e programit të studimit.	Edukimi” të tilla si: metoda të tërthorta Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit); Takime në grup (në fund të vitit), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës. Komisioni njofton në mënyrë zyrtare strukturat përgjegjëse dhe përgjatë procesit të monitorimit përdor format raporte që të japin mundësi të vlerësosh aspekte të ndryshme që lidhen me mënyrën sesi respektohen standartet nga strukturat përgjegjëse.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	KSBC pas realizimit të procesit monitorues, harton një draft-raport, i cili u përcillet departamenteve për reflektim. Kjo nënkupton që departamentet mund të argumentojë dhe qartësojnë disa aspekte që lidhen me konstatimet e këtij komisioni. GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni dokumenton në formë shkresore rezultatet dhe raportet e vlerësimeve. Procedura që ndiqet është e tillë që pas përfundimit dhe mbledhjes së të dhënave informacioni / raporti i dërgohet Rektoratit dhe çdo njësie bazë me qëllim marrjen e masave për përmirësime të mundshme në të ardhmen. Këto diskutohen dhe në mbledhje të Senatit Akademik.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se formati i raporteve të vlerësimit përfshin të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nëse përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në	Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se raporti i



<p>mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>vetëvlerësimin të programit të studimit kryhet në përfundim të çdo viti akademik dhe ky proces përfshin të gjithë aktorët duke filluar që nga Njësia Bazë me grupet e sigurimit të cilësisë.</p> <p>Përsa i përket strukturës që merret me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, ai është i lidhur me KSBC. Kjo strukturë monitoron standartet e cilësisë për të gjitha programet e studimit në rang universiteti. Grupi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë është ngritur nga departamenti me qëllim hartimin e një raport vlerësimi të brendshëm për këtë program studimi..</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësimit të pedagogëve si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, u konstatua se institucioni për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda e instrumente të ndryshme të tilla si: pyetësori i studentëve, takimet në grup që zhvillohen nga drejtuesi i njësive bazë. Instrumentat janë të hartuara në mënyrë të tillë që masin dhe vlerësojnë të gjithë komponentët e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se ndër metodat e drejtpërdrejta të përdorura nga institucioni përfshen vlerësimet e drejtpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë si dhe rishikimit të kurrikulave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës apo edhe kërkesave të personelit akademik apo studentëve. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies përmes monitorimit të silabuseve nga zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vlerësim të didaktikës përmes vlerësimit të stafit akademik nga një koleg me tituj, si dhe përmes vlerësimeve paralele të provimeve apo detyrave të studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së</p>	<p>Lidhur me këtë standart mësohet se institucioni realizon çdo semestër një sërë veprimtarish si vlerësimi i pedagogut nga studenti, relacioni për monitorimin e silabuseve, ankesat e studentëve si dhe</p>

<p>programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program</p>	<p>vetëvlerësimi i performancës së personelit akademik. Këto sondazhe i vihen në dispozicion përgjegjësit të departamentit me qëllim reflektimin për të ardhmen. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi ku përfshihen pyetësorët dhe fokus grupet e realizuara me studentët të cilat zhvillohen në baza periodike dy herë në vit pyetësorë dhe një herë në vit fokus grupe. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program me qëllim përmirësimin e cilësisë. Vlersohet puna e bërë nga institucioni në këtë drejtim.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni përpiqet të parashikojë dhe garantojë politika dhe procedura që sigurojnë rritjen e brendshme të cilësisë, kjo duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni garanton dhe bashkëpunon me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të parametrave të cilësisë. Për këtë ekzistojnë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton së detyrat dhe</p>

<p>njësiti, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>përgjegjësi të konkrete të palëve të përfshira në çështjet e cilësisë janë të parashikuara në rregulloren e NJSBC. KSBS përmes aktiviteteve që ndërmer synon të garantojë sigurimin e cilësisë. Për arritjen e këtij qëllimi janë angazhuar në realizimin e projekteve koordinatori i projektit, grupi i punës nga institucioni me anëtarë të cilët janë të profileve dhe mbulojnë punën në struktura të ndryshme si zyra e kurrikulës, komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë, njësia për kërkimin shkencor dhe angazhimin e anëtarëve të departamenteve sipas rastit dhe aktiviteteve.</p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në përbërjen e grupit të vlerësimit të brendshëm janë të përfshirë anëtarë të personelit akademik dhe studentë. Departamenti është përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë përmes mbështetjes me informacione dhe akses në të gjitha dokumentat që disponon, grupi i vlerësimit të brendshëm. Personeli ndihmës akademik e administrativ ka mbështetur punën e grupit të vlerësimit të brendshëm përmes informacionit dhe statistikave që lehtësojnë procesin.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit nuk ushtron detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë. Gjithashtu edhe përfshirja e studentëve nga bachelor dhe masterat në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Përbërja e GVB është e përbërë vetëm nga anëtarë të brendshëm të departamentit. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm apo bashkëpunëtorëve të ndryshëm, me të cilët departamenti bashkëpunon mund të ishte një mundësi e mirë për marrjen e opinionëve që do të përmirësonin cilësinë e këtij programi studimi.</p> <p><i>Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ sugjeron se institucioni duhet t'i kushtoj vëmendje të veçantë sugjerimeve dhe rekomandimeve të lëna nga ekspertët e jashtëm.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente. Politikat e institucionit në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së informacionit në funksioni të realizimit të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e KU "Wisdom". Në funksion të transparencës do të ishin të nevojshme vijimi i praktikës së mirë të nisur si diskutimet me stafin dhe studentët, fokusgrupet e ndryshme, etj. Këto veprimtari do të ndihmonin transparencën në ndarjen e informacionit me palët e interesuara dhe të përfshira, dhe gjithashtu do të lejonin marrjen e një feedback-u mbi mundësinë e përmirësimit të punës së grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se institucioni është i interesuar të ruajë dhe respektojë të dhënat e privatësisë, lirinë dhe etikën akademike –profesionale. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e KU "Wisdom". Raportet janë pasqyruar të plota pa ndërhyrje në shmangien e dajles së të dhënave për personat që janë pjesë e të dhënave që kanë kontribuar në drejtim të mësimdhënies në këtë program studimi këto vite, megjithatë të dhënat personale të stafit akademik japin informacion mbi kualifikimin e titujt që mbajnë, nuk evidenca që na japin mundësi të gjykojmë mbi cënimin e lirisë për të dhënat personale.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se insitucioni sigurohet që raportet dhe rezultatet e vetëvlerësimit të programit përfshijën edhe të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi. Institucioni në këto dokumenta kryen dhe adresimin e masave që duhen analizuar dhe reflektuar. Grupi i vlerësimit të brendshëm ka paraqitur rezultatet e vlerësimit të tij për këtë program studimi. Në përmbyllje të raportit të tij ka një analizë mbi pikat e forta dhe afirmimet dhe</p>



	<p>pikat e dobëta. Ka një tendencë për t'u fokusuar në evidentimit e pikave të forta dhe afirmimet më tepër, dhe përse i përket sugjerimeve për masat që mund të ndërmerren në drejtim të pikave të dobëta mbeten të paqarta format sesi mund të ndihmohet njësia bazë dhe kryesore, por edhe institucioni për të përmirësuar ato në të ardhmen.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, krijon grupin përmes delegimit të përgjegjësisë, strukturave përgjegjëse dhe mbështet punën e grupit përgjatë kryerjes së detyrës. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vet institucioni për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Ashtu sic ndërmerren reagime nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara nga grupi i vlerësimit të brendshëm.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni me anë të veprimtarive periodike si java e orientimit, sesione trajnimi të shumta që realizon në fillim të çdo viti akademik, informon dhe ndërgjegjëson studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Angazhimin e stafit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë e kërkon baza ligjore në funksion të cilësisë në mësimdhënie si edhe nga rregulloret e KU "Wisdom" dhe statuti, një sër strukturash të ngritura me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë përfshijnë në përbërje të tyre (KSBC, GVB).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave/Arteve në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi”

a. Pika të forta dhe afirmime:

1. Qendrat për realizimin e praktikës profesionale janë në përputhje me profilin e masterit shkencor në “Psikologji Shkollore dhe Edukimi” duke krijuar mundësi reale në drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale për studentët këtij program studimi;
2. Qendra e këshillimit psikologjik “Urtësia” dhe ajo e këshillimit të karrierës të përshtatshme për mbështetjen e veprimtarive në funksion të praktikës klinike dhe praktikës profesionale;
3. Praktika të mira, të ndërmarra nga institucioni në drejtim të përfshirjes së stafit akademik dhe studentëve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
4. Përfshirja e studentit në vlerësimet periodike të formave të mësimdhënies dhe të stafit akademik;
5. Abonimi në bibliotekën online Pro-Quest dhe COBISS Net;
6. Klima pozitive në komunikimin midis stafik akademik dhe studentëve të këtij programi studimi;
7. Nxitja e shkëmbimeve në arsimin e lartë për stafin akademik dhe studentët, përmes Erasmus +;
8. Veprimtaritë ekstrakurrikulare të realizuara nga institucioni ndihmojnë në avancimin në kërkimin shkencor për stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi;
9. Infrastruktura fizike në funksion të këtij programi studimi u jep mundësi studentëve të këtij programi për kushte të përshtatshme në të cilin realizohet procesi i mësimnxënies;

b. Pika të dobta:

1. Kurrikula e programit të studimit e ngarkuar me lëndë e module të përafërta e me element që jo në të gjitha rastet përkojnë me prioritetet e këtij program studimi;
2. Përdorimi i një literature të vjetëruar dhe që përsëritet për lëndë të ndryshme mësimore vlerësohet se ndikon negativisht në mospërmshjen e synimeve të lëndës;
3. Mungesa e një literature të avancuar për profilin e psikologjisë shkollore dhe të edukimit në gjuhën shqipe;

Rekomandime

1. Institucionin të shoh mundësinë e përmirësimit të këtij programi studimi duke e përafuar me programe të tjera si motra brenda dhe jashtë vendit (referuar Europsy³³⁴) duke realizuar ndërhyrje në vijimësi përgjatë viteve akademike në masën 20 % të lejuar nga ligji;
2. Institucioni të shoh mundësinë e përmirësimit të kurrikulës që në thelb ky program studimi përmes lëndëve dhe moduleve të synojë paisjen e studentit me njohuri dhe kompetenca që janë të ngjashme me atë që mund të marrë një student edhe nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në vend për këtë profil profesional;
3. Përsa i përket disa lëndëve të përafërta si “Psikologjia e fëmijëve me nevoja speciale”(lëndë e detytuar), “Çrregullimet autistike dhe trajtimi i tyre”(lëndë me zgjedhje), “Çrregullimet e të nxënit”(lëndë me zgjedhje), të cilat mund të grupohen në një lëndë të vetme, duke qene së njohuritë që synojnë të japin janë të ngjashme. Pra lëndët me zgjedhje të përfshihen në lëndën e detytuar dhe mbetet hapësirë për të plotësuar edhe boshllëqe të kurrikulës për t’u plotësuar me njohuri të tjera të nevojshme për psikologun shkollor;
4. Të rivlersohet mundësia e mospërfshirjes së lëndës mësimore “Cështje të psikolinguistikës” në këtë program studimi pasi është një lëndë që nuk i nevojitet detyrimisht një psikologu shkollor dhe kreditet e saj mund të zëvendësohen me një tjetër lëndë të nevojshme;
5. Të rivlersohet emërtimi dhe fokusi i lëndës “Psikologji e komunikimit klinik me fëmijët dhe adoleshentët” për të qenë më pranë rolit dhe kompetencave të një psikologu shkollor, duke ia dhënë fokusin drejt këshillimit në kontekstin shkollorë;
6. Gjithashtu, lëndët Psikologjia shkollore e zbatuar (lëndë e detyruar në vitin e parë të studimeve) të kalojë në vitin e dytë dhe të shkëmbehet me lëndën “Teoritë dhe modelet e mësimdhënies” (lëndë e vitit të dytë të masterit shkencor); ky sugjerim i nevojshëm për rrjedhën logjike dhe përfitim më të mirë të studentëve nga këto dy lëndë që janë në vijimësi me njëra-tjetrën;
7. Një angazhim i vazhdueshëm i stafit akademik në përditësimin e literaturës me publikime cilësore lidhur me fushën specifike të specializimit të këtij profili studimi, duke treguar kujdes në përzgjedhjen e literaturës që i përshtatet programit të studimit të ciklit të dytë dhe jo të rrezikohet përsëritja e të njëjës literaturë, e cila mund të jetë ezauruar përgjatë ciklit të parë të studimeve³³⁵;

³³⁴ Lunt I., Peiró J. P., Poortinga Y., Roe R. (2014) Standards and Quality in Education for Professional Psychologists; Hogrefe.

³³⁵ Aneks 3.11.1 Syllabuset 2020-2021.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle "Scientific Master" in "School Psychology and Education"

a. Strengths and affirmations:

1. Centers for the realization of professional practice are in accordance with the profile of the scientific master in "School Psychology and Education" creating real opportunities in terms of developing professional competencies for students of this study program;
2. The center of psychological counseling "Wisdom" and that of career counseling suitable for supporting activities in function of clinical practice and professional practice;
3. Good practices undertaken by the institution in terms of involving academic staff and students in national and international projects;
4. Involvement of the student in the periodic evaluations of the forms of teaching and of the academic staff;
5. Subscribe to the Pro-Quest and COBISS Net online library;
6. Positive climate in communication between academic staff and students of this study program;
7. Promoting exchanges in higher education for academic staff and students, through Erasmus +;
8. The extracurricular activities carried out by the institution help to advance in scientific research for the academic staff and students of this study program;
9. Physical infrastructure in function of this study program gives opportunities to students of this program for suitable conditions in which the learning process takes place;

b. Weaknesses:

1. The curriculum of the study program loaded with related subjects and modules with an element that does not in all cases coincide with the priorities of this study program;
2. The use of an outdated and repetitive literature for different subjects is considered to have a negative impact on the failure to meet the objectives of the subject;
3. Lack of an advanced literature on the profile of school psychology and education in the Albanian language;

Recommendation:

1. The institution should see the possibility of improving this study program by aligning it with other programs such as sisters at home and abroad (referring to Europsy) by carrying



out ongoing interventions throughout the academic years to the extent of 20% allowed by law;

2. The institution should see the possibility of improving the curriculum so that in essence this study program through courses and modules aims to equip the student with knowledge and competencies that are similar to what a student can receive from other institutions of higher education. instead for this professional profile;
3. Regarding some related subjects such as "Psychology of children with special needs" (compulsory subject), "Autistic disorders and their treatment" (elective subject), "Learning disorders" (elective subject), which can be grouped into a single subject, since the knowledge they aim to impart is similar. So elective courses should be included in the compulsory course and there is still room to fill the curriculum gaps to be filled with other knowledge necessary for the school psychologist;
4. To re-evaluate the possibility of not including the subject "Psycholinguistics issues" in this study program as it is a subject that is not necessarily needed by a school psychologist and its credits can be replaced with another necessary subject;
5. To re-evaluate the title and focus of the course "Psychology of clinical communication with children and adolescents" to be closer to the role and competencies of a school psychologist, giving the focus towards counseling in the school context;
6. Also, the subjects Applied School Psychology (compulsory subject in the first year of studies) to pass to the second year and to be exchanged with the subject "Theories and teaching models" (subject of the second year of scientific master); this suggestion is necessary for the logical flow and the better acquisition of students from these two subjects that are in continuity with each other;
7. A continuous commitment of the academic staff in updating the literature with quality publications related to the specific field of specialization of this study profile, showing care in the selection of literature that fits the study program of the second cycle and not to risk repetition of of the same literature, which may have been exhausted throughout the first cycle of studies;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	E	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT					X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT					X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT					X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE					X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE					X
VLERËSIMI TËRËSOR					X